

PRAPAVIJA, PIKËNISJA KONKRETE DHE FAKTORIZIMI I UÇK-ës



- Fatmir Lekaj -



Hyrje

Si në shumë raste të tjera në botë, edhe në rastin e shqiptarëve, Lëvizja Kombëtare nuk ka qenë tërësisht politikisht homogjene, që nga Lidhja e Prizrenit (1878), e veçanërisht pas vitit 1912. Megjithëkëtë, rrymat e ndryshme politike në kuadër të Lëvizjes Kombëtare pas vitit 1912, kanë qenë më shumë rezultat i kalkulimeve strategjike (se sa i indoktrinimeve ideologjike etj.), me synimin kryesor dhe të përbashkët për çlirimin e Kosovës me vise, drejt bashkimit kombëtar. Rrjedhimisht, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës me vise dhe Bashkim Kombëtar (pas vitit 1912), kryesisht karakterizohet nga gërshetimi i rezistencës aktive dhe pasive të shqiptarëve.

Rezistenca aktive, kundër pushtimit dhe sundimit serb të Kosovës që nga Lufta e Parë Ballkanike 1912, identifikohet përveç tjerash me: Lëvizjen Kaçake, Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, rezistencën kundër ri-pushtimit serb të Kosovës (gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore), dhe me grupet klandestine të pas Luftës së Dytë Botërore, që rezultuan me themelimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK-s) dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-s). Me fjalë të tjera, rezistenca aktive e shqiptarëve, pavarësisht rrethanave real-politike në kohë dhe hapësirë, ka qenë në vazhdimësi e karakterizuar nga idealizmi, përkushtimi dhe sakrificat, për çlirimin e pjesëve të okupuara të kombit shqiptar jashtë “Shqipërisë Londineze”, dhe për bashkimin e shqiptarëve në një shtet (union, federatë/konfederatë), bazuar në idealin kombëtar të Lidhjes së Prizrenit. Në këtë kuptim,

rezistenca aktive e shqiptarëve për Çlirimin e Kosovës me Vise dhe Bashkim Kombëtar, e ka një vazhdimësi të pashkëputur prej vitit 1912, si në aspektin strukturor, ku gjatë goditjeve të ndryshme që ka marr në kohë dhe hapësirë, ka arritur të riorganizohet në mënyra të ndryshme, dhe si në aspektin e individit, duke qenë e inkurajuar nga personalitetet me ndikim të jashtëzakonshëm, përveç tjerëve: Hasan Prishtina, Adem Demaçi, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Ukshin Hoti, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri e deri tek Adem Jashari dhe Albin Kurti.

Rezistenca pasive e shqiptarëve, në kuptimin e “politikës si art i së mundshmes”, identifikohet kryesisht (pas Luftës së Parë Botërore), me Partinë Legale Shqiptare, Bashkimi (Xhemijeti) në kuadër të Jugosllavisë Monarkiste, në krye me Ferat Dragën etj. Ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, identifikohet me udhëheqjen politike shqiptare të institucioneve të Krahinës së Kosovës në Jugosllavinë Federaliste, në krye me Fadil Hoxhën etj. Pas shembjes së murrut të Berlinit (1989) identifikohet me Lidhjen Demokratike të Kosovës, në krye me Ibrahim Rugovën etj., dhe pas Konferencës së Rambujes (1999), identifikohet kryesisht me udhëheqjen politike në krye me Hashim Thaçin etj. Gjithashtu edhe (në kuadër më të gjerë politik-kombëtar), udhëheqja politike e “Shqipërisë Londineze”, pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, në krye me Ahmet Zogun dhe Enver Hoxhën, ka qenë e karakterizuar nga një qasje real-politike, duke e përfshirë “luftën e ashpër për pushtet”, dhe në këtë vazhdë edhe qasja politike e udhëheqësve të më pastajmë (me disa ndryshime në rrethanat e reja, pas shembjes së murrut të Berlinit), në krye me Ramiz Alinë, Sali Berishën, Fatos Nanon etj.

Shikuar historikisht, vazhdimësia e rezistencës pasive e shqiptarëve, përkatësisht rezistenca politike institucionaliste (në Kosovë, por edhe në nivel kombëtar), ka shërbyer përveç tjerash, të amortizoj goditjet e regjimeve të Beogradit etj., që si qëllim final kishin të gjejnë “shkas” dhe “justifikim” për zhdukjen dhe dëbimin e tërësishëm të shqiptarëve nga Kosova dhe më gjerë, dhe për aneksimin e mëtutjeshëm të territoreve shqiptare. Ndërsa vazhdimësia e rezistencës aktive e shqiptarëve, përkatësisht Lëvizja Çlirimtare, ka shërbyer si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës, dhe në këtë vazhdë ka ndikuar për inkurajimin e procesit për realizimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni dhe në vise të tjera të banuara me shqiptar, në ish-Jugosllavi. Rrjedhimisht, rezistenca aktive dhe pasive e shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise, (përkundër sfidave, dobësive dhe divergjencave), ka qenë në masë të madhe komplementare, dhe kulmoi me luftën e lavdishme të UÇK-s.

Prapavija

Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës me Vise dhe Bashkim Kombëtar (pas Luftës së Dytë Botërore), karakterizohet nga tri rrymat politike: *çlirimtarët, institucionalistët dhe akademikët*.

Çlirimtarët, identifikohen me vazhdimësinë e rezistencës aktive, përkatësisht Lëvizjen Çlirimtare, e karakterizuar nga veprimtaria e grupeve klandestine që rezultoi me demonstratat e vitit 1968, ku ra dëshmorë Murat Mehmeti dhe u plagosën dhjetëra të tjerë. Demonstratat u iniciuan nga një grup i studentëve në Prishtinë në krye me Osman Dumoshin etj., që në fakt ishin celulë e të rinjve të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), e themeluar në vitin 1963, nga Adem Demaçi etj.¹ Konkretisht demonstratat filluan në Prizren

me 6 tetor 1968, në krye me Isa Demajn dhe bashkëveprimtarët e tij., i cili ishte koordinues i grupit të Prizrenit me grupin e studentëve të Prishtinës², dhe vazhduan në qytete të tjera, me kërkesat kryesore: “Duam vetëvendosje gjer në shkëputje”, “Duam Republikë”, “Duam Kushtetutë”, “Duam Universitet”, “Duam bashkimin e të gjitha viseve shqiptare me Kosovën” etj. Këto demonstrata e kanë pasur një ndikim të tërthortë edhe në kuadër të një procesi politik që kishte filluar në udhëheqjen jugosllave në vitin 1966 (i shkaktuar nga “lufta për pushtet” në mes Titos dhe Aleksandër Rankoviqit) dhe rezultoi me kushtetutën e re jugosllave të vitit 1974, në kuadër të së cilës u avancua edhe statusi politik i Kosovës. Rrjedhimisht, periudha gjatë fund-viteve `60 dhe fillim-viteve `70, karakterizohet nga një progres kulturor-politik në Kosovë, përveç tjerash: lejimi i përdorimit të flamurit kombëtar (1968), themelimi i Universitetit të Prishtinës (1969), njësimi i gjuhës letrare shqipe në Tiranë në vitin 1972, ku të pranishëm ishin edhe delegatët shqiptar, jashtë “Shqipërisë Londineze” (Kosova etj.), dhe kulmoi me Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974, që përcaktoi Kosovën si element konstituiv në kuadër të federatës jugosllave.

Institucionalistët, identifikohen me udhëheqjen politike shqiptare-institucionale të Krahinës së Kosovës, në krye me Fadil Hoxhën, Iljaz Kurteshin, Mahmut Bakallin etj., të cilët e kanë dhënë kontributin e tyre në kuadër të procesit politik që rezultoi edhe me Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974. Megjithëkëtë, gjatë këtij procesi, dhe në vazhdimësi, përkushtimi i institucionalistëve, ka qenë i karakterizuar nga një rezistencë pasive, në kuptimin se nuk kanë qenë proaktiv në kuadër të përpjekjeve për transformimin e Krahinës së Kosovës në Republikën e Kosovës, edhe pse kishte pengesa reale për këtë transformim. Historiani Noel Malcolm, renditë “tri pengesa” kryesore që penguan Kosovën të avancohet në Republikë, në vitin 1974. Pengesa e parë ishte teorike, e bazuar në doktrinën komuniste të zhvilluar në Bashkimin Sovjetik, që në fakt ishte edhe gurthemel i federatës jugosllave, dhe nënkuptonte se republikat ishin entitete për “kombet” dhe jo për “kombësitë”. Megjithëkëtë sipas tij, ky kriter teorik nuk respektohej plotësisht. Për shembull popullata rumanishtfolëse e Moldavisë që kufizohej me Rumaninë, e kishte republikën e vet në kuadër të Bashkimit Sovjetik. Pengesa e dytë praktike, nënkuptonte se Kosova si Republikë formale do të mund ti bashkohet Shqipërisë, dhe pengesa e tretë politike, nënkuptonte se avancimi i Kosovës në republikë formale do të krijonte indinjatë të madhe tek serbet në Serbi dhe tek serbet në Kosovë.³

Akademikët, identifikohen me veprimtarinë në kuadër të institucioneve shkencore të Kosovës: Institutin Albanologjik (1967) që fillimisht u udhëhoq nga Fehmi Agani, pastaj nga Idriz Ajeti, Rexhep Qosja etj. Entin e Historisë (1967), që më pastaj evoluoj në Institutin e Historisë së Kosovës, dhe u udhëhoq për shumë vite nga Ali Hadri. Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (1975) e udhëhequr fillimisht nga Esat Mekuli, pastaj nga Idriz Ajeti, Dervish Rozhaja etj., dhe veçanërisht me Universitetin e Prishtinës, ku fillimisht ishte rektor Dervish Rozhaja, pastaj Idriz Ajeti, Feriz Krasniqi, Gazmend Zajmi etj. Kjo elitë akademike, nuk arriti gjatë viteve `70 – `80, të determinojnë figura sikurse Haveli, Valenca, Sakharov etj., dhe (me ndonjë përjashtim) nuk karakterizohet nga përpjekjet e veçanta për transformimin e Krahinës së Kosovës në Republikën e Kosovës. Megjithëkëtë, kjo elitë akademike e ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në kuadër të veprimtarisë shkencore dhe ngritjes së sistemit të lartë arsimor në Kosovë, duke e përfshirë edhe kontributin e pedagogëve nga Shqipëria, që vinin gjatë viteve `70 për të ligjëruar në Universitetin e Prishtinës. Pas shembjes së murrin të Berlinit (1989), pjesa dërmuese e elitës akademike të Kosovës, u bë pjesë e Lidhjes

Demokratike të Kosovës (LDK-s), në krye me kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugovën.

Progresi kulturor-politik i shqiptarëve gjatë fund-viteve '60 dhe fillim-viteve '70, duke e përfshirë Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974, ishte një e arritur e madhe. Por njëkohësisht, nuk ishte ndonjë garanci e zgjidhjes së çështjes shqiptare në Jugosllavi. Sepse Kosova nuk kishte evoluar në një republikë formale që do të mund ti garantohej një siguri politike shqiptarëve në Jugosllavi, edhe pas vdekjes së Titos, i cili, prioritet parësor kishte pushtetin dhe stabilitetin politik dhe jo të ardhmen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Madje edhe përafrimi i Titos me Enver Hoxhën ishte strategjik. Malcolm, konstaton se pajtimi i Jugosllavisë me Shqipërinë, kishte të bënte se Tito ishte frikësuar paraprakisht nga pushtimi i Çekosllovakisë nga Bashkimi Sovjetik, dhe kishte nevojë për të gjitha shtetet antiruse në Ballkan. Ndërsa Shqipëria në këtë periudhë kohore, i kishte të prishura marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe nuk merrte subvencione nga sovjetikët. Rrjedhimisht, në fillim-vitin 1969, rezultuan marrëveshjet tregtare në mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, dhe pas disa muajsh edhe marrëveshja në bazë të së cilës erdhën (gjatë fillim-viteve '70), rreth 200 profesorë nga Shqipëria për të ligjruar në Universitetin e Prishtinës, duke përfshirë përdorimin e teksteve të botuara në Shqipëri.⁴

Për dallim të institucionalistëve dhe akademikëve, veprimtarët e Lëvizjes Çlirimtare, ishin idealist. Ideali për bashkim kombëtar dhe përvojat e hidhura historike të popullit shqiptar në Jugosllavi, para, gjatë, dhe pas luftës së dytë botërore, ishin motivacioni i tyre kryesor në përpjekjet për të transformuar Krahinën e Kosovës në Republikën e Kosovës, si një hap i domosdoshëm për sigurinë politike të shqiptarëve në Kosovë, (që do të shërbente edhe për sigurinë politike të shqiptarëve në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi), dhe njëkohësisht si një parakusht për bashkimin kombëtar të shqiptarëve në të ardhmen. Për këtë arsye, veprimtarët e Lëvizjes Çlirimtare nuk u magjepsen shumë, nga ndryshimet politike që solli kushtetuta jugosllave e vitit 1974, sepse këto ndryshime nuk e zgjidhnin çështjen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Madje, në kuadër të këtyre ndryshimeve pozitive të barazisë etnike, rezultuan edhe biefektet negative, sepse shqiptarëve u imponohej dhe u mundësohej më së shumti mobilizimi në radhët e partisë. Sipas Malcolm: *“...pabarazia e përgjithshme në punësimin publik, asnjëherë nuk u përmirësua: më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptar merrte rrogë shtetërore. Aty ku shqiptarët bënë përparimin më të madh ishte hyrja e tyre në radhët e partisë dhe të administratës lokale”*⁵ Rrjedhimisht, rekrutimi masiv i shqiptarëve në lidhjen komuniste, dhe privilegjet e pozitive partiake dhe burokratike, përveç anës pozitive, bartnin me vete imponimin, presionin dhe indoktrinimin, në kuptimin e lojalitetit dhe servilitetit ndaj Jugosllavisë dhe titizmit, dhe luftimin e veprimtarisë së Lëvizjes Çlirimtare. Në këtë vazhdë, rezultoi strategjia “përçaj dhe sundo” nga shërbimi i sigurisë shtetërore jugosllave, i dominuar nga Serbia (UDB), që nëpërmes privilegjeve, shantazheve dhe presioneve, përdorte një pjesë të shqiptarëve, për të luftuar veprimtarinë e Lëvizjes Çlirimtare.

Në mars-prill të vitit 1981, shpërthyen demonstratat e fuqishme në Kosovë me kërkesat socio-politike, që ndikuan përveç tjerash, për fillimprocesin e shembjes së themeleve të Jugosllavisë, dhe për ndërkombëtarizimin e çështjes politike të Kosovës. Reagimi i pushtetit serb ndaj demonstratave të vitit 1981, ishte shumë më brutal se sa ndaj demonstratave të vitit 1968. Forcat policore plagosën qindra demonstrues, ndërsa dëshmorë

ranë: Naser Hajrizi, Asllan Pireva, Xhelal Maliqi, Salih Abazi, Salih Zeka, Ruzhdi Hyseni, Rizah Matoshi, Sherif Frangu, Tahir dhe Nebih Meha, Nesimi Dervishdana, Salih Maloku etj. Iniciatorët e këtyre demonstratave (duke përfshirë dy zëdhënësit kryesorë, Ali Lajçin dhe Hydajet Hysenin), u dënuan me burgime të rënda. Në këtë vazhdë, vetëm në periudhën 80`-90`, u dënuan me burgime të rënda mijëra shqiptar për «veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë» ndaj të cilëve u përdorën tortura të rënda, ku pati edhe raste të vrasjeve gjatë torturave. Gjithashtu, në ushtrinë jugosllave u burgosën qindra dhe u vranë dhjetra ushtar shqiptar për «veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë». Konsiderohet se rreth 80% e të burgosurve politik në ish-Jugosllavi, kanë qenë shqiptarë.

Udhëheqësit politik shqiptar të institucioneve të Krahinës së Kosovës në krye me Fadil Hoxhën, Mahmut Bakallin, Azem Vllasin etj., edhe pse kishin një përvojë politike më të madhe, nuk u treguan mjaftueshëm të guximshëm dhe politikisht kreativ për ndonjë lloj koordinimi me iniciatorët e demonstratave të vitit 1981, në lidhje me kërkesën për “Republikën e Kosovës”, si një kërkesë e drejtë në kuadër të barazisë së popujve në Jugosllavinë federale. Së paku, nuk morën një qëndrim politik-diplomatik, që në parim të jenë pro kërkesës për “Republikën e Kosovës” dhe njëkohësisht kundër mënyrës së shtrimit të kësaj kërkesë nëpërmes demonstratave etj. Kjo mungesë koordinimi në mes politikës aktive dhe pasive të shqiptarëve, i ka pasur pasojat e veta në shumë aspekte, ngjashëm sikurse mungesa e koordinimit politik gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në mes Fadil Hoxhës dhe Shaban Polluzhës, Halim Spahisë etj. Duke përfshirë mungesën e koordinimit politik pas Luftës së Parë Botërore, në mes Ahmet Zogut dhe Hasan Prishtinës, Fan Nolit etj., dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, në mes Enver Hoxhës dhe Mithat Frashërit etj.

Për demonstratat e vitit 1981, pati edhe konspiracione në kuptimin se ishin të orkestruara nga qarqet e shërbimit sekret serb, rus etj., për të kthyer në regres fuqinë politike të shqiptarëve në Kosovë, që e kishin fituar në bazë të kushtetutës së vitit 1974. Në fakt ky ishte dhe mbeti një konspiracion dhe vlerësim antihistorik, sepse demonstratat e vitit 1981, ishin një vazhdimësi historike e rebelimit të shqiptarëve kundër regjimeve shtypëse të Beogradit prej vitit 1912, duke përfshirë demonstratat e vitit 1968, dhe veçanërisht ishin të ndikuara nga veprimtaria dhe shtypi i grupeve klandestine të viteve `70 - `80. Me fjalë të tjera, një pjesë domethënëse e shoqërisë studentore e Universitetit të Prishtinës, ishin të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga veprimtaria dhe shtypi i grupeve klandestine. Gjithashtu këto demonstrata ishin rezultat i kontekstit të përgjithshëm socio-politik në Kosovë. Në lidhje me këtë, ballkanologu norvegjez, Svein Mønnesland, përveç tjerash, shkruan:

“Mund të duket i çuditshëm rebelimi i shqiptarëve në një kohë kur kishin arritur të kenë më shumë të drejta se ndonjëherë më parë. Por "periudha e lulëzimit" në vitet '70, ndikoi në ngritjen e vetëdijes kombëtare, sidomos në mesin e të rinjve, që pashmangshëm rezultoi në rritjen e kërkesave politike. Pse Kosova nuk duhet të ketë status republike kur ka më shumë banorë sesa në Mal të Zi apo në Slloveni? Gjithashtu, për pakënaqësinë ndikonte që Kosova kishte mbetur ende zona më e varfër në vend”⁶

Supozohet se edhe “Shqipëria Londineze” mund të ketë pasur një ndikim të drejtpërdrejt ose të tërthortë në lidhje me demonstratat e vitit 1981, veçanërisht profesorët që vinin në Kosovë për të ligjësuar në Universitetin e Prishtinës, gjatë viteve `70.⁷ Pushteti në “Shqipërinë Londineze”, përkrahu publikisht demonstratat e vitit 1981, dhe në kuadër të kësaj përkrahjeje

përpiqej njëkohësisht të kontrollonte Lëvizjen Çlirimtare, me “përgjegjësinë e kalkulimit real-politik” që kishte si pushtet/shtet. Ndërsa veprimtarët e Lëvizjes Çlirimtare, për shkaqe patriotike dhe idealit për bashkim kombëtar, ishin lojal ndaj vendit amë (Shqipërisë Londineze) pavarësisht sistemit politik. Ketë më së miri e pasqyron intervista e njërit ndër personalitetet më të spikatura të Lëvizjes Çlirimtare, Jusuf Gërvallës, e publikuar me 20. janar 1982, në gazetën gjermane “Tagische Zeitung”, e veçanërisht dy përgjigjet e tij:

“Por cili është qëllimi i Lëvizjes Çlirimtare?”

Jusuf Gërvalla: Qëllimi jo vetëm i Lëvizjes Çlirimtare, por edhe i të gjitha forcave përparimtare është shkëputje nga Jugosllavia dhe Bashkimi me Shqipërinë Amë!

A arsyetohet kjo vetëm me përkatësi nacionale apo ka edhe aspekte shoqërore e politike. A do të kërkonit ju bashkimin pavarësisht se, në Shqipëri mbretëron sistemi radikal komunist, radikal demokratik ose një sistem i së drejtës?

Jusuf Gërvalla: Pavarësisht nga çfarëdo sistemi!”⁸

Pikënisja konkrete

Diaspora shqiptare në përgjithësi dhe emigracioni politik shqiptar në veçanti, e kanë pasur një rol shumë të rëndësishëm në kuadër të proceseve për komb-formimin, çlirimin dhe faktorizimin politik të shqiptarëve në Ballkan. Megjithatë, politizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, i ka pasur pasojat e veta edhe në emigracion. Sepse, deri në fillim-vitet `70, emigracioni politik shqiptar ka qenë kryesisht i preokupuar me ndonjë përjashtim (Hysen Tërpeza, Tahir Kernaja, Sami Repishti, Ihsan Toptani etj.), vetëm me veprimtarinë kundër regjimit diktatorial në Shqipëri, dhe jo me ndonjë veprimtari konkrete për çlirimin e Kosovës me vise.

Pas demonstratave të vitit 1981, regjimi i Beogradit i vuri në shënjestër edhe veprimtarët e Lëvizjes Çlirimtare, në kuadër të emigracionit politik shqiptar, të cilët kishin nisur gjatë viteve `70, veprimtarinë konkrete për çlirimin e Kosovës me vise, dhe konsideroheshin si një kërcënim politiko-diplomatik ndaj Serbisë, në lidhje me çështjen e Kosovës. Kjo ndikoi që shërbimi i sigurisë shtetërore jugosllave (UDB), të përpiqet të përçaj, frikësoj dhe të dobësoj sa më shumë, veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar, madje edhe nëpërmes organizimit të atentateve. Me 14. prill 1981, në Frankfurt të Gjermanisë u plagos rënd veprimtari Rasim Zenelaj. Ndërsa me 10. tetor 1981 në Bruksel të Belgjikës, u vra veprimtari, Vehbi Ibrahim (që të dy veprimtarët të Besëlidhjes Kombëtare Shqiptare në krye me Emin Fazliun). Gjithashtu në Bruksel, rreth 9 vite më vonë, përkatësisht me 25 shkurt 1990, u vra veprimtari Enver Hadri.

Me fjalë të tjera, Lëvizja Çlirimtare, (Pas Luftës së Dytë Botërore), e karakterizuar nga veprimtaria e grupeve klandestine, si brenda vendit (në trojet e banuara me shqiptar në ish-jugosllavi), ashtu edhe jashtë vendit që nga vitet `70 (në kuadër të emigracionit politik shqiptar), për shkak të rrethanave të vështira për veprim, ka pasur vështirësi të bashkohet formalisht në një organizatë me strukturë të qëndrueshme politike. Në këtë vazhdë, ndikimin vendimtar për përafrimin e një pjese domethënëse të grupeve klandestine, që vepronin në kuadër të Lëvizjes Çlirimtare, e ka pasur (me prapavijën dhe personalitetin e tij përbashkues) idealisti, veprimtari, intelektual, poeti dhe këngëtar, Jusuf Gërvalla. Rrjedhimisht, inicimi në

diasporë (në vigjilje të demonstratave të vitit 1981) për themelimin e organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK-s), në krye me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhosh Gërvallën, Ibrahim Kelmendin etj., (tre të parët u ekzekutuan në një atentat të UDB-s, në Shtutgard të Gjermanisë, me 17 janar të vitit 1982), dhe inkurajimi i veprimtarisë së LPK-s në Kosovë, në krye me Rexhep Malën, Nuhi Berishën etj., (të cilët ranë heroikisht me 12 janar të vitit 1984 në Prishtinë, në një përballje të armatosur e të pabarabartë nën rrethimin e forcave policore), është një pikënisje konkrete e fillesës së organizimit të rezistencës së armatosur në Kosovë.

Formalizimi i themelimit të LPK-s, e njohur fillimisht si Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ), është i bazuar edhe në platformën “Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës” e lëshuar në qarkullim në qershor 1981, nga Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Nezir Myrtaj etj., dhe bazuar në takimin e 17 shkurtit 1982, në mes të përfaqësuesve të dy grupeve klandestine, Sabri Novosellës dhe Abdullah Prapashticës, me Konsullin e Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxhën, (përndryshe i biri i Hoxhë Kadri Prishtinës - Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës). Ndërsa me 15 maj 1982, udhëheqjes së LPK-s, ju bashkëngjiti Xhafer Shatri⁹, i cili përfaqësonte grupin më të fuqishëm klandestin në Kosovë, gjatë viteve `70 (Grupi Revolucionar i Kosovës, i njohur më pastaj si Grupi Marksist Leninist i Kosovës dhe Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës).

Në këtë vazhdë, nga njëra anë, dega e LPK-s, brenda vendit (në trojet e banuara me shqiptar në ish-jugosllavi) e vazhdoi veprimtarinë çlirimtare gjatë viteve `80 - `90, përkundër rrethanave të vështira për veprim. Gjatë kësaj periudhe, strukturat e regjimit të Beogradit në Kosovë me vise, burgosën, torturuan dhe vranë veprimtarë dhe simpatizantë të LPK-s. Në kuadër të kësaj veprimtarie, gjatë viteve `80 - `90, u vranë nën rrethim dhe përballje të armatosur e të pabarabartë me forcat policore, u dënuan me burgje të rënda dhe vdiqën si pasojë e torturave, edhe disa ndër drejtuesit dhe veprimtarët më të spikatur të veprimtarisë klandestine dhe të degës së LPK-s, brenda vendit, përveç tjerëve: Bajram Bahtiri, Zijah Shemsiu, Fehmi Lladrovci, Xhavit Haziri, Xhabir Morina, Enver Topalli, Sejdi Veseli, Abdullah Tahiri, Hysen Gega, Metush Krasniqi, Kadri Osmani, Ahmet Haxhiu, Arif Seferi, Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Fadil Vata, Bejadin Hallaqi, Xhemajli Berisha, Tahir Lush Berisha, Hasan Ramadani, Mehë Ramë Uka etj. Kjo vazhdimësi e veprimtarisë së degës së LPK-s, brenda vendit, ka qenë jetike për mundësinë e organizimit të kryengritjes së armatosur në Kosovë në fund-vitet `90. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, një rol shumë të rëndësishëm e ka pasur, simboli i guximit akademik, Ukshin Hoti, i cili (përveçse me bashkëveprimtarët e tij, Halil Alidemajn etj., e kanë përkrahur hapur kërkesën për Republikën e Kosovës, gjatë demonstratave të vitit 1981), ka qenë një inkurajues i madh për veprimtarët e LPK-s.

Nga ana tjetër, dega e LPK-s, jashtë vendit (në kuadër të emigracionit politik shqiptar), e ka ndihmuar në vazhdimësi organizimin dhe riorganizimin (pas goditjeve) të degës së LPK-s, brenda vendit, dhe e ka pasur një rol të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Sepse në vazhdimësi organizoi demonstrata dhe protesta, në qendrat e shteteve perëndimore, me kërkesën për Republikën e Kosovës, duke e ushtruar njëkohësisht veprimtarinë lobiste dhe diplomatike. Në këtë drejtim, një kontribut të veçantë e kanë dhënë edhe disa struktura lobiste dhe të diplomacisë jo-formale të ish-emigracionit politik shqiptar, të themeluara para shembjes së murit të Berlinit: Organizata Rinia Shqiptare-Kosovare në Botën e Lirë, në New York (1970), Komiteti i Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në

Belgjikë (1983), Komiteti i Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Zvicër (1985), Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (1988), që bashkëpunonte drejtpërdrejt me LPK-n, Shoqata Migjeni në Slloveni (1989), Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane (1989) etj. Kjo veprimtari lobiste dhe e diplomacisë jo-formale, ndikoi përveç tjerash për kyçjen e çështjes së Kosovës në kuadër të kancelarive diplomatike të shteteve perëndimore, dhe në kuadër të “Procesit të Helsinkit” (si një proces shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare në mes Lindjes dhe Perëndimit, që rezultoi me fitoren e shteteve perëndimore). Në fund-vitin 1989 u themelua Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, i cili u udhëhoq fillimisht nga, Bajram Kelmendi, Zekiria Cana, Zenun Qelaj etj., dhe më pastaj u intensifikua veprimtaria e këtij këshilli nën udhëheqjen e Adem Demaçit. Ndërsa në muajin prill 1990, u themelua Komiteti Kosovar i Helsinkit, në krye me Gazmend Pulën.

Faktorizimi

LPK-ja, ishte e vetmja organizatë e fuqishme politike e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe në diasporë që në programin e vet, nuk e përjashtonte kryengritjen e armatosur, si mjet të fundit për çlirimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi (pasi që të gjitha mjetet tjera politiko-diplomatike të konsumohen). Pas themelimit të LPK-s, në vitin 1982, katër mbledhjet e përgjithshme të kësaj organizate që janë mbajtur në vitin 1987, 1989, 1991, 1993 dhe këshillat e përgjithshëm që kanë rezultuar nga këto mbledhje të përgjithshme, si organi më i lartë udhëheqës i LPK-s, e kanë ruajtur kontinuitetin organizativ për mundësinë e kryengritjes së armatosur në Kosovë, pas konferencës së Dejtonit. Në mbledhjen e IV të përgjithshme të vitit 1993 (e mbajtur në shtëpinë e veprimtarit, Fatmir Brajshorit), u mor vendimi për fillimin e kryengritjes së armatosur, në krye me udhëheqësin kryesorë të LPK-s, në Kosovë, Xhavit Hazirin, i cili më pastaj u burgos, së bashku me udhëheqës të tjerë të spikatur të LPK-s, në Kosovë, Ahmet Haxhiun, Bejadin Hallaqin etj. Në bazë të këtij vendimi të mbledhjes së IV të përgjithshme, filloi shndërrimi i këshillave të LPK-s në Kosovë, në njësi të armatosura. Meqë dega e LPK-s, brenda vendit, e veçanërisht udhëheqja e saj, goditej në vazhdimësi (me burgosje, tortura dhe vrasje), dega e LPK-s, jashtë vendit (në kuadër të emigracionit politik shqiptar) kishte kompetencat që në situata të caktuara të merrte përgjegjësinë për udhëheqjen e përgjithshme të organizatës. Kjo bartje e kompetencave ndodhi konkretisht pas mbledhjes së IV të përgjithshme, sepse pjesa dërmuese e udhëheqjes së degës së LPK-s në Kosovë, u burgosën, dhe disa prej tyre që i shpëtuan arrestimeve, emigruan jashtë vendit. Në kuadër të degës së LPK-s, jashtë vendit, në kohë dhe hapësirë, ndikim të madh kanë pasur, përveç tjerëve: Hasan Malaj, Saime Isufi, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Shatri, Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli, Xhavit Haliti, Gjyle Krasniqi, Jashar Salihu etj.

Gjatë fillim-viteve '90, LPK, dega jashtë vendit, formoi 3 sektorë të rëndësishëm, (sektorin e organizimit politik të drejtuar nga Fazli Veliu, Muhamet Kelmendi etj., sektorin e lidhë-mbajtjes të drejtuar nga Emrush Xhemajli, Rexhë Ibërdemaj, Adem Grabovci, Gafurr Elshani dhe sektorin e rëndësisë së veçantë të drejtuar nga Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Azem Syla), duke e përfshirë themelimin e fondit “Vendlindja Thërret” të kryesuar nga Jashar Salihu. Ndërsa si sektor i propagandës shërbeu në vazhdimësi redaksia e “Zërit të Kosovës” (e

drejtuar nga Skënder Durmishi, Xhafer Shatri, Mustafë Xhemajli, Avni Dehari, Beqir Beqa, Bislim Elshani, Adnan Asllani etj.). Gjatë viteve 1993 – 1995, pjesë të këshillave të LPK-s në Kosovë dhe në Maqedoni u shndërruan në njësi të para të armatosura, (në krye me Adem Jasharin, Ilaz Kodrën, Sahit Jasharin, Sami Lushtakun, Durmish Gashin, Halil Çadrakun, Selim Gashin, Xheladin Gashin, Sokol Bashoten, Fatmir Limajn, Ragip Shalën, Rexhep Selimin, Mujë Krasniqin, Isa Krasniqin, Asllan Pantinen, Skender Rexhepin, Fadil Nimanin, Rexhep Bislimin, Qerim Kelmendin, Adrian Krasniqin, Gursel Sylejmanin, Beqir Limanin, Xhemajl Jasharin, Ismet Sylejmanin, Shaqir Shaqirin, Jonuz Musliun etj.), dhe me insistimin e tyre, kryesia e LPK-së, dega jashtë vendit, merr vendim për fillimin e lëshimit të komunikatave. Me 17.11.1994 u lëshua komunikata e parë ushtarake dhe u mor vendimi që organizimi i ri ushtarak të quhet (emërtohet), Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK.¹⁰ Në këtë vazhdë, një fraksion “radikal” i LPK-s, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), ju bashkëngjiti UÇK-s. Megjithëkëtë, faktorizimi i UÇK-s, në kuptimin e shtrirjes së idesë tek masat popullore për domosdoshmërinë dhe fuqizimin e kryengritjes së armatosur, ballafaqohet me shumë pengesa (si në Kosovë dhe si në diasporën shqiptare). Një ndër pengesat ishte Lëvizja Paqësore (LDK), në kuptimin se një ndër aspektet kryesore të politikës së Lëvizjes Paqësore, ishte pengimi i revoltës së dhunshme. Në lidhje me këtë, Malcolm, përveç tjerash shkruan:

“Politika themelore e ndjekur nga Rugova në LDK që nga viti 1990 ka pasur tri aspekte: së pari, për ta penguar revoltën e dhunshme; së dyti, për të “ndërkombëtarizuar” problemin e Kosovës, që do të thotë për t’i kërkuar format e ndryshme të ndërhyrjes politike ndërkombëtare (duke filluar me ndërmjetësimin diplomatik e deri te vënia e protektoratit të Kombeve të Bashkuara mbi Kosovën); dhe, së treti, për të mohuar sistematikisht legjitimitetin e pushtetit serb, duke i bojkotuar zgjedhjet dhe regjistrimet dhe duke krijuar së paku konturet e një aparati shtetëror të “Republikës së Kosovës”. Synimi i parë nga këto të triat ka qenë i suksesshëm deri në një farë mase, gjë që vështirë se mund të përfytyrohej nga kush njih traditën luftarake të shqiptarëve dhe historinë e tyre të gjatë të kryengritjeve të armatosura. Synimi i dytë i dha mundësinë Rugovës që të bënte një numër të madh vizitash nëpër kryeqytetet të huaja, por me këtë u arrit pak, si p.sh. miratimi i ca rezolutave nga disa forume, siç janë Kombet e Bashkuara dhe Parlamenti Evropian. Si qëllimi i dytë i politikës, ashtu edhe qëllimi i tretë, kontestojnë tok një ide – e cila ende njihet si parim nga fuqitë më të mëdha të Perëndimit – se statusi i Kosovës është vetëm një çështje e brendshme e Serbisë. Me formimin e institucioneve të një republike të ndarë, shqiptarët e Kosovës ishin angazhuar në një strategji politike që fillon me kushtin “sikur të ishte”. Të sillesh sikur Kosova nuk ishte pjesë e Serbisë, do të dukej, me një fjalë, një shtirje e thjeshtë; mirëpo nëqoftëse kjo strategji do të vazhdojë me vendosmëri për një kohë mjaft të gjatë, atëherë qeveritë e jashtme do të jenë të detyruara, më në fund, të pranojnë se i kishin besuar një fantazie, kur kishin vazhduar të trajtonin Kosovën si pjesë përbërëse të shtetit të Serbisë. Pyetja që u shtrohej shqiptarëve, së këndejmi, ishte: edhe sa do të jenë në gjendje të durojnë dhe sa duhet të vuajnë ndërkohë?”¹¹

Për hovin e mobilizimit në kuadër të Lëvizjes Paqësore (LDK-s), gjatë fillim-viteve '90, ndikuan një sërë ndodhish dhe aktiviteteve politiko-shoqërore në Kosovë, përveç tjerash: me 2 nëntor 1989, ranë heroikisht dy udhëheqësit kryesorë të LPK-s, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, nën rrethim dhe përballje të armatosur e të pabarabartë me forcat policore. Me 2 shkurt 1990, filloi aktivitetin aksioni për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave (i iniciuar nga disa veprimtarë të LPK-s, dhe i udhëhequr nga profesor, Anton Qeta etj.), dhe evoluoi në një mobilizim dhe solidaritet gjithë-popullor. Gjatë demonstratave të vitit 1989-1990 (si reaksion kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës), ranë dhjetëra dëshmorë. Në qershor 1990, u themelua Bashkësia e Sindikatave të Pavarura të Kosovës në krye me Hajrullah Goranin. Me 2 korrik 1990, delegatët shqiptarë (të legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës, që filloi

punën me 4 dhjetor 1989) e shpallën Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Rreth dy muaj më vonë, përkatësisht me 7 shtator 1990, në sallën e Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik, ku ishin të pranishëm pothuajse të gjithë delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, u miratua edhe Kushtetuta e Kosovës (Kushtetuta e Kaçanikut), që ishte përpiluar paraprakisht nga Gazmend Zajmi, Ejup Statovci etj. Në këtë vazhdë, disa pjesëtarë të ish-strukturave udhëheqëse institucionaliste të Kosovës, por edhe disa veprimtarë të mirënjohur të Lëvizjes Çlirimtare, (kryesisht ish të burgosur politik), ju bashkuan strukturave udhëheqëse të LDK-s. Gjithashtu, me pluralizmin politik në jugosllavi, përveç LDK-s, u themeluan edhe disa parti tjera të shqiptarëve në Kosovë (Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Liberale, Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Republikane, Parlamenti Rinor që në fakt ishte bërthama e Partisë Parlamentare etj.), dhe u organizuan në kuadër të një Këshilli Koordinues të udhëhequr nga LDK.

Këshilli Koordinues i Partive Politike të Kosovës (i përbërë nga Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Ali Aliu, Ramush Tahiri, Veton Surroi, Shkëlzen Maliqi, Reshat Nurboja etj.), e emëroi një Komision Qendror për organizimin dhe mbajtjen e referendumit popullor (i përbërë nga Fehmi Agani, Fatmir Sejdiu, Rifat Blaku, Hivzi Islami, Ramush Tahiri, Ejup Statovci, Ismet Salihu etj.). Përkundër rrethanave të vështira, referendumi u mbajt me 26 -30 shtator 1991, ku mbi 90% të shqiptarëve të Kosovës votuan pro-pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht e legjitimuan Deklaratën e 2 korrikut dhe Kushtetutën e 7 shtatorit. Gjithashtu me 24 maj 1992, u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare¹² dhe presidenciale në Kosovë, të cilat i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe kryetari i saj, Ibrahim Rugova, u zgjodh President. Gjithashtu paraprakisht, me 19 tetor 1991, ishte themeluar Qeveria e Kosovës në Egzil, në krye me Bujar Bukoshin, që fillimisht u vendos në Lubjanë të Sllovenisë dhe më pastaj nga viti 1992 në Bon të Gjermanisë.

Represioni gjatë fillim-viteve '90, ndikoi që të ketë edhe iniciativa pothuajse publike për organizimin e kryengritjes së armatosur të shqiptarëve, kundër regjimit neofashist të Milosheviqit. Me këtë qëllim, një grup i shqiptarëve nga Kosova, kishte shkuar për stërvitje ushtarake në Shqipëri, në vitin 1991. Ndërsa me shpërthimin e luftës në Kroaci dhe Bosnje, disa ushtarak shqiptar të ish-armatës jugosllave etj., kishin iniciuar ngritjen e një fronti të përbashkët që do të përfshinte shqiptarët me palët tjera në luftë, kundër regjimit neofashist të Milosheviqit. Këtyre iniciativave (që shumë shpejtë u dekonspiruan), nuk ju kushtua ndonjë interesim dhe mbështetje e veçantë, nga udhëheqësit e politikës paqësore të Kosovës. Megjithëkëtë, ndikimi i Lëvizjes Paqësore për të penguar revoltën e dhunshme të shqiptarëve, në masë të madhe ishte i logjikshëm politikisht, deri në përfundimin e konferencës së Dejtonit. Por çuditërisht as para dhe veçanërisht pas konferencës së Dejtonit, nuk u sinkronizua ndonjë lloj strategjie e përbashkët (plan B), në mes LDK-s (duke përfshirë Qeverinë e Kosovës në Egzil) dhe LPK-s. Mos përfshirja e çështjes së Kosovës në konferencën e Dejtonit, ishte njëkohësisht dështim i politikës paqësore. Në lidhje me këtë, Malcolm përveç tjerash shkruan:

“Fundi i luftës në Bosnjë nuk e solli edhe përfundimin e krizës në Kosovë. Ky fakt ishte vetëm një goditje për prestigjin e Rugovës. Ai, në të vërtetë, për katër vjet me radhë e kishte bindur popullin e vet se duhet të kenë durim derisa bashkësia ndërkombëtare të impononte një zgjidhje përfundimtare për ish-Jugosllavinë, në të cilën do të respektoheshin edhe interesat e tyre. Mirëpo, zgjidhja e paraqitur nga amerikanët në Dejton, të Ohajos, në nëntorin e vitit 1995, i la shqiptarët e Kosovës pikërisht aty ku

ishin. E vetmja përkrahje në favor të Kosovës ishte një pajtim nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara se “muri i jashtëm” i sanksioneve kundër Serbisë (duke përfshirë edhe mohimin e të drejtës për pjesëmarrje në Fondin Monetar Ndërkombëtar), do të mbetej derisa Beogradi të përmirësohej gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përndryshe, Marrëveshja e Dejtonit në përgjithësi ndikoi në konsolidimin e sundimit të Milosheviqit në Serbi: diplomatët e Perëndimit deklaruan haptazi se ata i ishin atij mirënjohës për përpjekjet e tij “për vendosjen e paqes”, dhe se e konsideronin atë si një forcë konstruktive në rajon, largimi i të cilit mund të shpinte në një destabilizim”¹³

Rrjedhimisht, ngjashëm sikurse udhëheqja politike shqiptare e institucioneve të Krahinës së Kosovës në krye me Fadil Hoxhën etj., që u konsumua, duke konsideruar se të drejtat politike të bazuara në kushtetutën jugosllave të vitit 1974, e kishin zgjidhur çështjen politike të Kosovës në Jugosllavi. Gjithashtu edhe politika e LDK-s, në krye me Ibrahim Rugovën etj., u konsumua duke konsideruar (edhe pas konferencës së Dejtonit) se çështja politike e Kosovës, zgjidhet vetëm me metoda paqësore. Njëri ndër protagonistët e proceseve politike në Kosovë gjatë viteve '90 dhe më pas, Blerim Shala në pasthënien e librit *Rrëfimi për Luftën dhe Lirinë* (1999), paksa në mënyrë nihiliste dhe antihistorike, përveç tjerash shkruan:

“Kurrë Serbia nuk do ta braktisë Kosovën. Kurrë Perëndimi nuk do të ndërhyjë ushtarakisht në Kosovë. Kurrë Kosova nuk do të bëhet e lirë dhe e pavarur. Ishin këto qëndrime politike të cilat ishin lidhur si gur rreth qafës së secilit shqiptarë në vitet e nëntëdhjeta. Ideja e pavarësisë, e cila ishte zyrtarizuar në vitin 1990-1991, me vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe me votën e qytetarëve në Referendum, në të nëntëdhjetat, u bë një fjalë goje, një llomotitje, një mburojë për të mbajtur monopolin e një pushteti të rremë që ndërtohej pra mbi prononcimin verbal në dobi të shtetit të Kosovës. Në vete, secili prej nesh, druante që për të gjallët tanë nuk do të përjetonim asnjë ditë të vetme, asnjë çast të vetëm në liri. Robëria dukej si kob i përjetshëm. Në këtë skenë fati dhe politike, gjithçka u përmbys, me të paraqitur të disa dhjetëra vetave, të cilët kishin atë bindjen e moçme shqiptare se nuk mund të ketë liri pa luftë dhe se nuk mund të ketë pavarësi pa flijim. Mbase nuk e kanë ditur në fillim se çka është lufta, se me kë në të vërtetë kapeshin fyt për fyt, se ç’gjë mund të dalë nga gjithë kjo rrëmujë, por e dinin mirë, tepër mirë, se të gjitha iluzionet ishin soshur, se afati i përdorimit të fjalëve përulëse kishte kaluar, se vdekja për liri kishte shumë më tepër vlerë sesa jeta nën Serbi.”¹⁴

Duhet të kihet parasysh, se UÇK, ishte parësisht rezultat i përpjekjeve të pandërprera (dhe dytësisht i individëve të caktuar) të Lëvizjes Çlirimtare për Çlirimin e Kosovës me Visë dhe Bashkim Kombëtar, prej vitit 1912, dhe shërbeu si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës. Njëkohësisht duhet të kihet parasysh, se Lëvizja Paqësore (LDK), në krye me akademikun urtak me përgjegjësi të madhe politike dhe të ndikuar nga post-strukturalizmi francez, Ibrahim Rugovën, e ka pasur rolin kryesor për shmangien e luftës në fillim-vitet '90, në mes popullit shqiptar të Kosovës dhe regjimit neofashist të Milosheviqit. Përndryshe, ka pasur gjasa të mëdha që gjenocidi me përmasa aq të mëdha që ndodhi në Bosnjë, të ndodhte me përmasa edhe më të mëdha në Kosovë. Gjithashtu, strategjia paqësore e LDK-s, kontribuoi për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan, sepse (për dallim të Kroacisë dhe Bosnjës) shpërthimi i luftës në Kosovë, kishte potencialin të zgjeronte luftën përtej territoreve të ish-Jugosllavisë. Fatkeqësisht, shtetarët perëndimorë, që nga fillimi i konfliktit të armatosur në Jugosllavi (në fillim-vitet '90), u treguan të ç’koordinuar në ndërmarrjen e hapave konkretë dhe efektiv për ta ndaluar/ndëshkuar dhunën e regjimit neofashist të Milosheviqit. Në këtë vazhdë, edhe gjatë konferencës së Dejtonit e shpërfillën dhe e injoruan Ibrahim Rugovën, duke mos e inkuadruar si një protagonist të rëndësishëm për zgjidhjen e krizës politike në Jugosllavi. Me fjalë të tjera, shtetet perëndimore, edhe pse kishin keqardhje më shumë ose më pak për situatën e rëndë të shqiptarëve në Kosovë, nuk ishin në gjendje të shpërblejnë politikën paqësore të

Kosovës që sakrifikoje me vite në kurriz të shqiptarëve për zgjidhje politike paqësore, dhe për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan.

Konferenca e Dejtonit i humbi të gjitha shpresat se shqiptarët mund të çliroheshin vetëm me politikën paqësore. Megjithatë, sikurse grevat e minoriteteve dhe përpjekjet e institucionalistëve në krye me Kaqusha Jasharin etj., duke e përfshirë një numër të caktuar të delegatëve shqiptar të Kuvendit të Kosovës, gjatë vitit 1988 dhe fillim-vitit 1989 (kundër nismës për suprimimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës) si faktor i brendshëm, dhe shembja e murit të Berlinit, si faktorë i jashtëm, që e patën ndikimin e vet, për t'i dhënë legjitimitet ndërkombëtar, Lëvizjes Paqësore të Kosovës (LDK-s). Gjithashtu politika e Lëvizjes Paqësore (para konferencës së Dejtonit) si faktorë i brendshëm, dhe gjenocidi në Bosnjë, si faktorë i jashtëm (që preku thellë ndërgjegjen e shteteve perëndimore) e patën ndikimin e vet, që ti japin legjitimitet ndërkombëtar luftës së më vonshme të UÇK-s. Në kuptimin se shqiptarët e Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, kishin provuar me vite të zgjidhin problemin e Kosovës pa luftë, por ishin refuzuar nga Milosheviqi, dhe se shtetet perëndimore nuk mund të toleronin të ndodhë në Kosovë e njëjta përmasë gjenocidiale, që kishte ndodhur në Bosnjë. Veçanërisht duke e marr parasysh faktorin gjeopolitik, ngase një konflikt i armatosur në Kosovë (për dallim të Bosnjës) e kishte potencialin e zgjerimit të luftës, përtej kufijve të ish-Jugosllavisë. Në lidhje me kontekstin politik në Kosovë pas konferencës së Dejtonit, Mønnesland përveç tjerash, shkruan:

“Në vitet 1996-97, filluan të shfaqen informatat për forcat e armatosura guerile shqiptare. Deri në këtë kohë, shqiptarët, shumë kënd e befasuan, duke mos ju përgjigjur dhunës me mjete të dhunshme. Fillimisht ishin grupe të shpërndara dhe jo mirë të organizuara, të cilat e quanin vetën, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇK. Zona kryesore e tyre ishte rajoni kodrinor i Drenicës në perëndim të Prishtinës. Presidenti Rugova u distancua nga këto grupe dhe për një kohë mohoi se ato ekzistonin. Ndërsa veprimtari i të drejtave të njeriut, Adem Demaçi, e mbështeste UÇK-në dhe dëshironte të shërbente si zëdhënës i tyre.....”¹⁵

Pas konferencës së Dejtonit (dhe çlirimit të Kroacisë me forcat e veta, në vitin 1995), u intensifikuan aksionet e armatosura të UÇK-s. Në këtë vazhde, edhe UÇK pësoi goditje të njëpasnjëshme, e veçanërisht në vitin 1997. Përveçse u arrestua koordinatori i UÇK-s, në Kosovë, Nait Hasani etj., u vranë edhe disa ndër drejtuesit më të spikatur të UÇK-s, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Hakif Zejnullahu, Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi etj. Me 1 tetor 1997, përfaqësues të Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës (Muhamet Mavraj, Albin Kurti, Bujar Dugolli, Driton Lajçi, Ilir Dugolli etj.), në krye me rektorin Ejup Statovcin, organizuan demonstratën e fuqishme studentore, që njëkohësisht nënkuptonte një lloj mbështetje për UÇK-n. Me 28 nëntor 1997, në Llaushë të Drenicës, gjatë varrimit të mësuesit Halit Gecaj, i vranë nga forcat e policisë serbe, në praninë e qindra njerëzve, tre ushtarë të UÇK-s, dolën haptas para të pranishmëve dhe u thanë se UÇK-ja ekziston.¹⁶ Gjithashtu në diasporë, me 09 dhjetor 1997, një veprimtar i LPK-s, në Skandinavi, deklaroi publikisht për radiotelevizionin norvegjez (NRK), se UÇK ekziston dhe se shqiptarët në diasporë kanë filluar mobilizimin për të mbështetur financiarisht dhe ushtarakisht UÇK-n.¹⁷ Në fund të vitit 1997, kryesia e LPK-s, e aprovoi stemën e UÇK-s, e dizajnuar nga veprimtari Adnan Asllani.¹⁸ Me 22 shkurt 1998, në Zyrën Amerikane në Prishtinë, Adem Demaçi takoi të Dërguarin Special të SHBA-së për Ballkanin, Robert Gelbart, i cili paraprakisht e kishte cilësuar UÇK-n, si një organizatë “terroriste”. Sipas biografit të Adem Demaçit, Shkëlzen

Gashit, në këtë takim: “*Demaçit i kërkohet ta mbështesë tezën se UÇK-ja është organizatë terroriste. Por ai jo veç kundërshton, por pohon me këmbëngulësi se UÇK-ja është organizatë çlirimtare*”¹⁹ Në këtë vazhdë, përkundër vështirësive të mëdha, rezistenca e armatosur dhe heroike e UÇK-s, vazhdoi në krye me Adem Jasharin, Muj Krasniqin, Ilir Konushevcin, Shkëlzen Haradinajn, Bahri Fazliun, Agron Rrahmanin, Xhevat Berishën, Remzi Ademajn etj, dhe paralelisht vazhduan me këmbëngulësi edhe përpjekjet politiko-diplomatike të UÇK's.

Dy ndodhitë e mëdha

Në këtë vazhdimësi, dy ndodhi të mëdha e bënë ndryshimin e madh për faktorizimin e UÇK-s. *Ndodhia e parë*, është e ngjashme me rënien heroike në krye të detyrës të udhëheqësve të LPK-s, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës etj., në një periudhë kyçe historike, përkatësisht pas demonstratave të vitit 1981, që kontribuoi për një inkurajim dhe mobilizim më të fuqishëm të Lëvizjes Çlirimtare, në kuadër të LPK-s. Ngjashëm, në një periudhë kyçe historike, rezistenca heroike, dhe rënia në mars të vitit 1998, e patriotit altruist, prijësit të Lëvizjes së Armatosur të UÇK-s, Adem Jasharit, dhe 57 anëtarëve të familjes së tij, (ku u masakruan 58 persona nga ana e regjimit neofashist të Milosheviqit), kontribuoi për një mobilizim shumë të fuqishëm të Lëvizjes Çlirimtare, në kuadër të UÇK-s.

Në kuadër të këtij mobilizimi të domosdoshëm, LPK, organizoi shkuarjen në Kosovë të një pjese të veprimtarëve me përvojë, përveç tjerëve: Ismet Jashari, Fehmi Lladrovci, Xhevë Krasniqi-Lladrovci, Ahmet Kaçiku, Agim Bajrami, Sejdi Sejdiu, Skënder Çeku, Xhemajl Fetahu, Fatmir Limaj, Ramush Haradinaj, Sami Lushtaku, Shukri Buja, Nasim Haradinaj, Hashim Thaçi, Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Abdyl Mushkolaj, Kadri Veseli, Nazmi Brahimaj, Azem Sylja, Adem Grabovci, Avdi Muja, Imri Ilazi, Sabri Kiqmari, Selim Krasniqi, Metush Zenuni, Agron Gërvalla, Demir Demiri, Cenë Aliçkaj, Muharrem Dina²⁰, Ujkan Nikçi etj. Gjithashtu, UÇK-s, ju bashkëngjiten ushtarakët e parë: Agim Qela, Bekim Berisha, Agim Ramadani, Ekrem Rexha, Tahir Sinani, Bislim Zyrapi, Naim Maloku, Sali Veseli, Rifat Sylejmani etj.

Me 24 mars 1998, forcat serbe rrethuan fshatin Gllogjan në Dukagjin dhe e bënë një sulm (të ngjashëm sikurse ndaj familjes Jashari), ndaj familjes Haradinaj, e cila tashmë ishte vigjilente për mundësinë e ndonjë sulmi të papritur. Sulmi ndodhi me 24 mars 1998, dhe familja Haradinaj me bashkëluftëtar bëri një rezistencë të suksesshme që ndikoi të zbrapsë forcat serbe. Kjo rezistencë heroike në krye me komandantin Ramush Haradinaj, i inkurajoi mijëra shqiptarë të tjerë në rajonin e Dukagjinit, ti bashkëngjiten UÇK-s.

Pjesa tjetër e LPK-së u bë mbështetja kryesore politike, diplomatike, financiare e logjistike për UÇK-në, nga jashtë territorit të luftimeve: Fazli Veliu, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti, Raif Gashi, Sejdi Gega, Refik Hamiti, Jashar Salihu, Bardhyl Mahmuti, Rexhë Ibërdema, Sahit Krasniqi, Hasan Ukëhaxha, Murat Jashari, Shefit Xhaferi, Ibrahim Kelmendi, Xhavit Hoxha, Salih Bicku, Xhavit Bajraktari, Agush Buja, Musa Demiri, Halil Selimi, Ramiz Lladrovci, Gafurr Zendeli, Rexhep Halimi, Muharrem Elshani, Afrim Emiri, Sahadete Zhitia, Selam Bajrami, Pleurat Sejdiu, Begzat Gashi²¹ Ramadan Avdiu, Sabit Veseli, Shaban Muja, Xhevat Bislimi, Sheradin Berisha, Haki Morina, Ibish Neziri, Lulëzim Etemaj, Ibrahim Xhemajli etj. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, përveç tjerash inicimi dhe inkurajimi për

përkrahje masive të UÇK-s, nga diaspora shqiptare, nëpërmes demonstratave etj., ishte i domosdoshëm për faktorizimin dhe sensibilizimin ndërkombëtar të luftës legjitime të UÇK-s. Sipas ish-kryetarit të LPK-s, Bedri Islamit:

“Pas demonstratës dhe metingut masiv të Lëvizjes në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që do të zhvillohej në Gjermani, në vitin 1996, nën kujdesin e Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe në drejtimin e Fehmi Lladrovci, tashmë hero i Kosovës, dhe të Ibrahim Kelmendit, vendi tjetër më i parë ku do të zhvillohej një demonstrim i tillë, do të jetë Norvegjia. Kjo do të jetë edhe pika më kulmore e parapërgatitjes së mbështetjes fuqishme të luftës dhe kjo u bë realitet, në një masë kohore shumë të shkurtër, që nga dërgimi i ndihmave, vullnetarëve, spitalit fushor e deri tek gazetaret e diplomatët norvegjezë, e më tej, skandinavë apo anglezë. Ka qenë një mbështetje totale, e cila zë vendin e saj të veçantë në historinë e re të Kosovës”²²

Në muajin mars 1998, u paraqit “publikisht” në një intervistë, drejtuesi i sektorit të rëndësisë së veçantë të LPK-s Xhavit Haliti etj.²³ Kjo intervistë e ka rëndësinë e vet, sepse për herë të parë zyrtarisht për mediat paraqitet personi i autorizuar nga LPK, dhe i cilësuar si personi kryesor i UÇK-s (sidomos deri në këtë kohë). Sektori i rëndësisë së veçantë në kuadër të LPK-s (që kishte për detyrë të organizojë dhe koordinoj kryengritjen e armatosur në Kosovë), që nga fillimi ishte më i pavarur krahasuar me sektorët tjerë të LPK-s, dhe pas vitit 1998, për shkaqe që dihen dhe nuk dihen, u vet-pavarësua edhe më shumë, duke u shndërruar në shtabin qendror të UÇK-s dhe drejtorinë politike, dhe më pastaj në Shtabin e Përgjithshëm. Mënyra e këtij transferimi është konsideruar anashkalim i vet organizatës (LPK-s), që de jure ishte pjesë e saj por de facto vepronte si strukturë e re paralele. Veçanërisht u konsiderua si anashkalim, pozicionimi i Hashim Thaçit (pa autorizimin e duhur të LPK-s) në pozitën e drejtorit të drejtorisë politike të UÇK-s, i cili gradualisht dhe sidomos gjatë Konferencës së Rambujesë, e akumuloi pushtetin politik brenda UÇK-s - LPK-s. Ndoshta kjo kishte të bënte pjesërisht edhe me vet aspektin organizativ si “fenomen universal”. Studiuesi Robert Michels, në studimin e tij të famshëm *Partitë politike: Një studim sociologjik i tendencave oligarkike të demokracisë moderne* (1911), konstaton se të gjitha organizatat pashmangshmërisht rezultojnë në “ligjin e hekurt të oligarkisë”. Në kuptimin se me zhvillimin e një organizate, një grup personash, duke kontrolluar resorët, linjat e informacionit etj., dalëngadalë e akumulojnë pushtetin në kuadër të organizatës. Madje sipas kësaj teorie (“ligji i hekurt të oligarkisë”), edhe në kuadër të organizatave me intencë të njëmendta demokratike dhe me dëshirat për ndarje të duhur të pushtetit, dalëngadalë rezultojnë një “grup personash” që akumulojnë pushtetin brenda organizatës. Megjithatë, kjo teori (që shpeshherë cilësohet si pothuajse i vetmi “ligj” në kuadër të shkencave shoqërore), është modifikuar nga studiues të tjerë të mëvonshëm.

Me zgjedhjen e Bedri Islamit, kryetar të LPK-s, në vitin 1998, u arrit të bëhej menaxhimi më i mirë i mundshëm (marr parasysh rrethanat), duke shmangur përçarjen brenda LPK-s, në mes sektorit të veçantë (tashmë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-s) dhe kryesisë së LPK-s, respektivisht Këshillit të Përgjithshëm të LPK-s. Përndryshe, thellimi i përçarjes do të kishte efekt fatal për luftën çlirimtare. Në vazhden e faktorizimit të UÇK-s, përveç tjerash, me 15. qershor 1998, u paraqit me një deklaratë të guximshme në lajmet për Kosovën në Televizionin shqiptar, zëdhënësi i UÇK-s, brenda vendit, Jakup Krasniqi.²⁴ Me 24 qershor 1998, në Junik të Kosovës ndodhi një takim (që pati efekt të madh në mediat ndërkombëtare), në mes disa ushtarëve të UÇK-s, në krye me Hajdin Abazin dhe të Dërguarin special të ShB-së për Ballkanin, Richard Holbrooke, i cili në ndërkohë ishte emëruar në postin që kishte më

parë, Robert Gelbart.²⁵ Me 29. qershor 1998, u realizua një takim i rëndësishëm në mes zëdhënësit të UÇK-s, jashtë vendit, Bardhyl Mahmutit dhe Richard Holbrooke, në Forumin Ndërkombëtar të Crans-Montanas, në Zvicër.²⁶ Ndërsa me 2 korrik 1998, gazeta e mirënjohur zvicerane “Le Temps”, botoi deklaratën e Xhafer Shatrit (në cilësinë e Ministrit të Informatave të Qeverisë së Kosovës në Egzil, me seli në Gjenevë), i cili kishte kontakte të drejtpërdrejta në OKB, ku përveç tjerash thuhej:

“E konfirmoj gjithashtu dhe qartas se lindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është rezultat logjik i terrorit serb që po zgjat që 17 vjet dhe i një indiference të padurueshme të bashkësisë ndërkombëtare për fatin tonë. Po përpiqem gjithashtu të bind të gjithë se anëtarët e kësaj organizate nuk janë terroristë, por njerëz që po sakrifikohen për popullin e tyre..... Është e njohur botërisht se, në një mënyrë apo në një tjetër, ministri që nga vjeshta e vitit 1997 mbron publikisht idenë se pas kaq vitesh të përpjekjeve pacifiste që nuk dhanë fryte, lufta e armatosur është bërë e domosdoshme për çështjen e Kosovës.”²⁷

Shtabi i përgjithshëm i UÇK-s, për shkak të shumë faktorëve dhe shpejtësisë së zhvillimit të ngjarjeve nuk arriti të organizoj në nivel të duhur strukturën ushtarake të UÇK-s. Përveç tjerash nuk u arrit që komandantët të transferohen (nga vendlindjet/vendbanimet e tyre) në vende tjera në Kosovë. Gjithashtu fillimisht, udhëheqja kryesore e UÇK-s, karakterizohej nga një lloj provincializmi, sepse përveç drejtorit politik të UÇK-s, edhe komandanti i përgjithshëm i UÇK-s etj., ishin nga zona e Drenicës. Në këtë vazhdë pati nguti me lëshimin në qarkullim të komunikatave të caktuara që ende krijojnë huti. Kjo para se gjithash është pasojë e mos koordinimit politik, sidomos pas konferencës së Dejtonit, për një plan B, (për një organizim të përbashkët të kryengritjes së armatosur në Kosovë), në mes LDK-s (duke e përfshirë Qeverinë e Kosovës në Egzil), dhe LPK-s., por siç thotë populli “faji mbetet jetim”. Megjithatë, kjo nuk i zbehtë sakrificat dhe luftën heroike dhe të suksesshme të UÇK-s kundër regjimit neofashist të Milosheviqit (si “Davidi kundër Goliatit”), dhe rrolin e UÇK-s, si një ndër guerilat më të suksesshme në botë.

Ndodhia e dytë, është gjithashtu e ngjashme me ndodhin para shumë dekadash në kuadër të Lëvizjes Çlirimtare. Sikurse idealisti dhe intelektual, Hasan Prishtina, që e pati ndikimin e rëndësishëm për orientimin politik të Lëvizjes Kaçake, duke i dhënë dimension të gjerë kombëtar (antiprovincialist). Roli i simbolit të rezistencës kombëtare, dhe i drejtave të njeriut, fituesit të çmimit Sakharov, Adem Demaçit, i cili me 13 gusht 1998, e mori përgjegjësinë e përfaqësimit të përgjithshëm politik të UÇK-s, me seli në Prishtinë, i mbështetur nga sekretari, Albin Kurti etj., ndikoi fuqishëm për mobilizimin edhe më të madh të UÇK-s, në nivel kombëtar. Ndërsa, diaspora shqiptare në përgjithësi, dhe përfaqësuesit politik të UÇK-s në diasporë në veçanti, (kryesisht veprimtar të LPK-s, të mirë-shkolluar në universitetet prestigjioze perëndimore dhe të emëruar nga drejtoria politike e UÇK-s, kryesia e LPK-s, dhe nga Përfaqësuesi i Përgjithshëm Politik i UÇK-s, Adem Demaçi), nëpërmes takimeve me shtetar perëndimor, debateve televizive etj., e kanë dhënë një kontribut të madh për sensibilizimin ndërkombëtar të luftës legjitime të UÇK-s. Përveç tjerash, me 10 nëntor 1998, u realizua takimi zyrtar në mes delegacionit të përfaqësuesve të UÇK-s në diasporë, Sabri Kiçmari etj., me Ministrin e Jashtëm të Austrisë, Wolfgang Schüssel në Bruksel (gjatë kësaj periudhe Austria ishte udhëheqëse e radhës së BE-s).²⁸ Në këtë kuadër, takime të ngjashme pati edhe në mes përfaqësuesit të UÇK-s në Norvegji, me Ministrin e Jashtëm të Norvegjisë, Knut Vollebæk, (njëkohësisht kryetar i organizatës për siguri dhe bashkëpunim

evropian-OSBE-s), i cili e ka pasur një rol të rëndësishëm negociues për dërgimin e misionit të vëzhguesve të OSBE-s, në Kosovë gjatë luftës²⁹, duke e përfshirë kontributin e përfaqësuesve politik të UÇK-s në Francë, Angli, SHBA etj. Në këtë vazhdë, një numër i caktuar i intelektualëve, akademikëve, dhe aktivistëve të shoqërisë civile në Kosovë, në krye me Rexhep Qosen, Veton Surroin etj., dhe në diasporë në krye Ismail Kadarenë, Shenasi Ramën, Daut Dautin, Muhamedin Kullashin etj., e kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për mbështetjen politiko-diplomatike të UÇK-s, e veçanërisht qeveria dhe diplomacia formale e “Shqipërisë Londineze” etj.

Në janar 1999, u themeluan institucionet informative të UÇK-s, radio “Kosova e Lirë dhe agjencia e lajmeve “Kosovapress”. Themelimi i këtyre institucioneve informative ishte iniciuar nga shtabi i përgjithshëm i UÇK-s, (Jakup Krasniqi, Shaban Shala, Ramë Buja, Kadri Veseli etj.), dhe u arrit të realizohej me kontributin e dhënë në mënyra të ndryshme nga: Ahmet Qeriqi, Nezir Myrtaj, Mentor Hoxha, Basri Beka, Shaqir Shaqiri, Islam Berisha, Bajram Jashari, Bekim Haxhiu, Blerim Peja, Xhevdet Gashi, Musa Jashari, Isë Krasniqi, Hilmi Ramadani, Nusret Pllana, Martin Çuni, Rizah Asllan Berisha, Berat Luzha, Xhevdet Gashi, Blerim Peja, Enver Tefik Gashi, Rizah Berisha, Milaim Berisha, Elez Durmishi, Ismet Sopi, Fadil Berisha, Nuri Bega, Ismet Behxheti, Rauf Dhomi, Efraim Kastrati etj.³⁰

Me përshkallëzimin e krizës humanitare në Kosovë, UÇK u forcua edhe më shumë, duke u përkrahur nga atdhetarët me ndikim, pa marrë parasysh subjekteve politike shqiptare që u takonin, edhe nga diaspora (Sali Çekaj, Ahmet Krasniqi, Tahir Zemaj etj.). Madje mobilizimi në kuadër të UÇK-s, përfshiu edhe mobilizimin ushtarak nga vendet e largëta (SHBA-të etj.), siç është shembulli i Batalionit Atlantiku etj., dhe veçanërisht shembulli i sakrificës nga ky Batalion, i tre vëllezërve Bytyqi, të cilët gjatë një misioni humanitar për të shpëtuar fqinjët e tyre romë, u burgosën nga forcat serbe dhe më pastaj u ekzekutuan. Kjo njëkohësisht vërteton se UÇK, nuk ishte kundër pakicave (minoriteteve). Në kuadër të luftës së lavdishme të UÇK-s, ka mjaft raste ku nga disa anëtar të një familje ranë dëshmorë, siç është rasti i vëllezërve Ismet, Muharrem dhe Nazim Asllani etj.

Për bashkësinë ndërkombëtare (paralelisht me faktorizimin e UÇK-s), ishte më rëndësi që UÇK-ja (veçanërisht udhëheqja e UÇK-s), të vihej nën kontroll, dhe në këtë kuadër të kihet kontroll edhe mbi negociatat që po përgatiteshin. Sipas studiuesit, Mark Weller, “*Që nga pranvera (1998) forcat serbe kishin nisur një ofensivë të rëndësishme, duke e zhvendosur UÇK-në nga disa zona për të cilat thoshte se i kontrollonte. Thuhej se ky veprim nuk ishte kundërshtuar ndërkombëtarisht, sepse qëllimi ishte të evitohet që UÇK-ja të kishte një rol dominues në negociatat që po vinin*”³¹ E tëra rezultoi me iniciimin e organizimit të konferencës së Rambujesë në Francë, në fillim-vitin 1999. Udhëheqja politike e UÇK-s, u sfidua shumë nga dokumenti i propozuar për negociata në Konferencën e Rambujesë, ngase nuk mund të pranonte zgjidhje për Kosovën në kuadër të Serbisë. Në pikënisje, ky dokument garantonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative Jugosllave (RFJ-së) de facto të Serbisë, mbi Kosovën, dhe parashihte një autonomi për Kosovën, që nuk ishte në nivel as me autonominë që kishte Kosova në bazë të kushtetutës së vitit 1974. Megjithëkëtë, udhëheqja e UÇK-s, ishte e gatshme të bej kompromise si zgjidhje të përkohshme, që hapte një perspektivë të sigurt politike për Kosovën, duke e përfshirë edhe përfaqësuesin e përgjithshëm politik të UÇK-s, Adem Demaçin. Në lidhje me këtë, autori i librit biografik për Adem Demaçin, Shkelzen Gashi, përveç tjerash shkruan:

“Në fund të nëntorit 1998, Demaçi paralajmëron se çfarëdo përpjekjeje që në çfarëdo mënyre synon me e lanë Kosovën koloni të Serbisë a të Jugosllavisë, është krejt e papranueshme. Porse pranon që UÇK-ja mund ta bëjë një kompromis: Kosova të jetë republikë në kuadër të mbetjes jugosllave – bashkë me Serbinë dhe Malin e Zi – veçse me garancinë e SHBA-së dhe të BE-së që, pas skadimit të një afati trevjeçar, kjo republikë ta gëzojë të drejtën për vetëvendosje”³²

Presioni i bashkësisë ndërkombëtare me platformën e paraqitur për negocimin e statusit të përkohshëm të Kosovës, përçau udhëheqjen politike të UÇK-s. Një pjesë e përfaqësuesve të UÇK-s, në krye Hashim Thaçin, pas shumë presioneve dhe hamendësimeve, pranuan platformën negociuese, ndërsa LDK etj., e kishin pranuar paraprakisht platformën negociuese. Qëndrimi refuzues i përfaqësuesit të përgjithshëm politik të UÇK-s, Adem Demaçit, sekretarit, Albin Kurtit, duke e përfshirë komandantin e përgjithshëm të UÇK-s (të emëruar nga Adem Demaçi), Sylejman Selimin etj., ndikoi në njëfarë mënyre të tërthortë të forcoj pozicionin e përfaqësuesve të tjerë të UÇK-s, në negociatat gjatë Konferencës së Rambujesë, në kuptimin që të mos pranojnë zgjidhje pa perspektivë politike për Kosovën. Delegacioni i shqiptarëve që u kryesua nga Hashim Thaçi, pas shumë hezitimeve (më shumë dhe më pak), e pranoi marrëveshjen e Rambujesë gjatë procesit negociator, dhe e nënshkroi me 18 mars 1999 në Paris të Francës. Një gjë shpresëdhënëse për perspektivën politike të Kosovës, ishte se kapitulli 8, pika 3 e marrëveshjes, e përcaktonte se zgjidhja finale për Kosovën, përveç tjerash, do të bazohet në “vullnetin e popullit”³³, edhe pse shprehja “vullneti i popullit”, nuk ishte e konkretizuar.

Milloseviqi e refuzoi këtë marrëveshje, sepse nuk pranoi (siç parashihte kjo marrëveshje) stacionimin e trupave paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO, dhe se kjo marrëveshje pas 3 vitesh, parashihte një lloj referendumi për Kosovën.³⁴ Si pasojë e refuzimit dhe vazhdimit të krimeve ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, regjimi neofashist i Milloseviqit u ndëshku me sulmet ajrore ushtarake të NATO-s, që nisën me 24 mars 1999. Në këtë vazhdë, nga këndvështrime të ndryshme (politike, ushtarake dhe morale) pati kritika ndaj mënyrës së intervenimit të NATO-s. Në lidhje me këtë, Mønnesland, përveç tjerash shkruan:

“Kritikët në Perëndim konsideronin se NATO e kishte të pamundshme të arrinte qëllimin pa i futur trupat tokësore. Ekspertët ushtarakë shpjegonin se trupat tokësore ishin të domosdoshme për të kontrolluar një territor. Disa gjithashtu konsideronin se ishte e pamoralshme të luftohej pa i ekspozuar për humbje trupat vetanake. Por politikanët perëndimor u zbrapsën nga mendimi për të futur trupat tokësore të cilat do të kishin edhe humbje. Megjithatë, rezultoi se trupat tokësore nuk qenë të domosdoshme për tu arritur presioni i duhur politik”³⁵

NATO, vetëm me intervenimet ushtarake ajrore që zgjatën 3 muaj, pa futjen e trupave tokësore, nuk mundi të mbrojë popullatën civile në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, forcat serbe vranë rreth 12 mijë shqiptarë të Kosovës, dhunuan mijëra femra, shkatërruan dhjetëra mijëra shtëpi dhe deportuan rreth një milion shqiptarë nga Kosova. Me fjalë të tjera intervenimi i NATO-s, në Kosovë nuk ndodhi sikurse intervenimi për çlirimin e Kuwait-it, në vitin 1990-91, nga aleatët perëndimorë, të cilët përdorën trupat tokësore. Rrjedhimisht, çlirimi i Kosovës, është në radhë të parë rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës me vise (prej vitit 1912), që kulmoi me UÇK-n, e veçanërisht meritë e dëshmorëve dhe viktimave të luftës, dhe e gjithë popullit shqiptar. Duke e përfshirë

mbështetjen e shtetit amë (Shqipërinë Londineze) dhe intervenimin ushtarak ajrorë të NATO-s, në krye me SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, të cilëve shqiptarët u janë përjetësisht mirënjohës.

Tri pasojat kryesore të mungesës së ndërhyrjes tokësore, janë viktimat shqiptare, kompromisi për rezolutën 1244 dhe nisma e ndarjes së Mitrovicës. Në fakt përgjegjësinë kryesore për mungesën, së paku të një strategjie të armatosjes për vetëmbrojtje të popullatës civile shqiptare në Kosovë nga regjimi i Milosheviqit (gjatë intervenimit të NATO-s), e kishte elita politike shqiptare. Sepse, fatkeqësisht mungoi një bashkëpunim paraprak në mes LDK-s, duke përfshirë Qeverinë e Kosovës në Egzil dhe LPK-s, (sidomos pas konferencës së Dejtonit), që më pastaj i pati pasojat e veta, përveç tjerash: për nismën e ndarjes së Mitrovicës, vonesën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Trazirat e Marsit 2004, mungesën e forcimit të institucioneve të drejtësisë (shtetit ligjor), Gjykatën Speciale etj.

Pas gjithë kësaj tragjedie që ndodhi në Kosovë gjatë vitit 1998-1999, dhe duke e marr parasysh se “Marrëveshja e Rambujesë” mund të cilësohej moralisht e pavlefshme, madje edhe juridikisht e pavlefshme, duke u bazuar në klauzolën *rebus sic stantibus* të së drejtës ndërkombëtare, ku parashihet se një marrëveshje humb vlefshmërinë mbasi të jenë ndryshuar radikalisht rrethanat nën të cilat ajo është nënshkruar.³⁶ Fatkeqësisht, liderët e Kosovës, vazhduan me divergjenca gjatë dhe pas Konferencës së Rambujesë, duke mos i shfrytëzuar si duhet momentet historike. Në ndërkohë Milosheviqi, (i cili paraprakisht kishte kalkuluar se sa më shumë që zgjasin sulmet ajrore, aq më shumë rriteshin gjasat të përçahen shtetet anëtare të NATO-s), gjatë dorëzimit të tij, e shfrytëzoi situatën duke e vështirësuar perspektiven politike të Kosovës nëpërmes Marrëveshjes Ahtisaari-Çernomyrdin. Në lidhje me këtë, Mønnesland përveç tjerash shkruan:

“Marrëveshja Ahtisaari-Çernomyrdin, e cila u pranua nga Beogradi në fillim të qershorit, dallonte nga marrëveshja e Rambujesë, edhe pse shumë nga pikat kryesore ishin të njëjta. Për Milosheviqin, i cili duhej t’ia shiste marrëveshjen popullit të tij si një fitore, ishte më e rëndësishmja që tani OKB-ja, rezultoi si një autoritet suprem, dhe se trupat paqeruajtëse nuk ishin në emërtim trupa të NATO-s. E rëndësishme ishte gjithashtu se marrëveshja e re nuk përmendte asgjë lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, tranzicionin kalimtar tre-vjeçar ose referendumin. Një parakusht për zbatimin e marrëveshjes ishte rekomandimi i Këshillit të Sigurimit i OKB-së, që grupi G-8 i vendeve më të rëndësishme të industrializuara të hartojë draft rezolutën ku gjithashtu mori pjesë edhe Rusia (Kina abstenoj nga votimi). Kur gjithashtu Serbia plotësoi kërkesën e NATO-s për të filluar tërheqjen e trupave të veta nga Kosova, NATO i ndërpreu sulmet ajrore. Tërheqja serbe nga Kosova ndodhi siç ishte planifikuar dhe në mënyrë të rregullt. U bë paqe në Jugosllavi, por detyrat që pritnin ishin enorme. Marshimi i trupave të NATO-s në Kosovë shkoi pa probleme të mëdha, dhe ushtarët u pritën si shpëtimtarë nga shqiptarët e intuiziasmuar. Por roli i rusëve ishte i paqartë, dhe nëpërmjet një manovre befasuese rusët arritën t’i vejnë mbroth NATO-s dhe të vendosin disa qindra burra në aeroport, të cilët u përshëndetën me mirëseardhje nga serbët. Për NATO-n ishte e rëndësishme të ketë një bashkëpunim me Rusinë, pa e ndarë Kosovën në një sektor shqiptar dhe serb. Një problem tjetër për NATO-n ishte marrëdhënia me UÇK-në, që e konsideronin veten si ustallarë legjitim të Kosovës së lirë. Menjëherë pas Rambujesë, UÇK-ja formoi një "qeveri" me liderin e UÇK-së, Hashim Thaçin, si kryeministër. Tani UÇK-ja dëshironte të merrte përsipër administrimin e krahinës. Por sipas marrëveshjes, UÇK-ja duhej të çarmatosej. Në këtë vazhde, pasuan shfaqje konfliktesh në mes UÇK-së dhe NATO-s, dhe në mes fraksioneve të ndryshme të shqiptarëve. UÇK ishte në opozitë të ashpër ndaj udhëheqësit të moderuar të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugovës, i cili gjatë sulmeve të NATO-s, u mbajt në arrest shtëpiak nga serbët, dhe u shfaq në televizionin serb në "negociatat" me Milosheviqin”³⁷

Vazhdimësia e përpjekjeve të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës me Vise dhe Bashkim Kombëtar, (pas vitit 1912), kulmoi me luftën e UÇK-s. Datë e themelimit formal të

UÇK, konsiderohet komunikata e parë e lëshuar me 17.11.1994, ku u mor vendimi që organizimi i ri ushtarak të quhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK, që në fakt bazohej në vendimin (për fillimin e kryengritjes së armatosur) të mbledhjes së IV të përgjithshme të LPK-s. Jo në kuptimin se grupe dhe struktura të armatosura që bënin përpjekje çlirimtare nuk kishte edhe më herët, përkundrazi ato ishin të shumta dhe vepronin me vite. Madje mund të thuhet se të gjithë çlirimtarët e Kosovës me vise, ndër vite (nga viti 1912, të frymëzuar nga kryeideologu, Hasan Prishtina) janë UÇK, por konkretisht data e formimit formal të UÇK-s, konsiderohet data e komunikatës së parë të UÇK-s, pas mbledhjes së kryesisë së LPK-s. Në kuptimin e unifikimit të grupeve të armatosura nën siglën e UÇK-s, të koordinuara, të mbështetura politikisht dhe me logjistik etj., nga LPK. Me fjalë të tjera, sikurse që u unifikuan grupet klandestine më herët, nën siglën e LPK-s, ashtu u unifikuan edhe grupet e armatosura më vonë, nën siglën e UÇK-s. Rrjedhimisht pikënisja për kategorizimin formal të veteranëve të UÇK-s, do duhej të fillonte nga mbledhja e IV e përgjithshme e LPK-s, deri në rezistencën heroike dhe sakrificën sublime të familjes Jashari, me 7 mars 1998 (si kategori e parë). Ndërsa pas 7 marsit 1998, deri në fillimin e intervenimit të NATO-s, me 24 mars 1999 (si kategori e dytë), dhe pas 24 marsit 1999 deri në çlirimin e Kosovës me 12 qershor 1999 (si kategori e tretë). Njëkohësisht duhet nënvizuar se çdo ndarje e UÇK-s nga trashëgimia e saj konkrete prej vitit 1912, është më shumë ndarje analitike se sa ndarje historike dhe meritokratike. Sepse UÇK, nuk është rezultat i një vakumi socio-politik, por rezultat i një procesi konkret historik, që nuk ndahet as nga LPK, dhe as nga grupet klandestine të pas Luftës së Dytë Botërore etj. E veçanërisht nuk mund të ndahet nga fillesa e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës me vise dhe Bashkim Kombëtar, pas vitit 1912 (e inkurajuar nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri etj.), tashmë e inkarnuar në Lëvizjen Vetëvendosje etj.

Përfundim

Bazuar në historianë, gjeografë, poetë dhe dramaturg të antikitetit (por edhe në autorë të tjerë të kohës së mëvonshme), etnia shqiptare që nga lashtësia pellazgo-ilire e ka një vazhdimësi të gjatë historiko-kulturore.³⁸ Shqipja (përveç greqishtes) është e vetmja gjuhë që ka mbijetuar nga një gjuhë antike e Ballkanit, dhe emrat e përveçëm: toponimet, emrat e njerëzve dhe të fiseve, të ruajtura në mbishkrimet latine ose greke si dhe në veprat e historianëve antikë, përbëjnë provat e vlefshme për lidhjen e shqipes me ilirishten.³⁹ Njëkohësisht, si pasojë e pushtimeve, sundimeve (duke e përfshirë rivalitetin në mes perandorive të ndryshme që nga antikiteti), etnia shqiptare pësoi tkurrje, asimilim, migrim, përfshirë migrimet gjatë periudhave të mëvonshme historike në Itali, Greqi, Bullgari, Ukrainë, Turqi etj. Në këtë vazhdë, edhe keqpërdorimi i nacionalizmit nga vendet fqinje, pati pasojë tragjike për shqiptarët.

Ngjashëm sikurse keqpërdorimi i feve, i komunizmit, i demokracisë etj., edhe nacionalizmi u keqpërdor gjatë historisë, duke rrëshqitur në atë, që filozofi Lars Svendsen, e quan “e keqja idealiste” (proto-fashizëm, fashizëm, nazizëm, neo-fashizëm etj.). Rrjedhimisht, hyrja në epokën e nacionalizmit (epokën e komb-formimeve) gjatë fundshekullit XVII dhe fillim-shekullit XVIII, ndikoi për fillim-procesin e komb-formimeve edhe në zonën e Ballkanit, veçanërisht pas Traktatit të Shën-Stefanit (1878), ku ideologjia nacionaliste u

keqpërdor deri në ekstrem, sidomos nga proto-fashizmi serb etj. Me fjalë të tjera, procesi i krijimit të shteteve kombëtare në zonën e Ballkanit dhe më gjerë, rezultoi me pasoja të dhimbshme (krime, spastrime etnike dhe persekutime), veçanërisht ndaj popujve me vazhdimësi të gjatë etnike: shqiptarëve, armenëve etj. Pasoja të ngjashme (të shkaktuara nga keqpërdorimi i ideologjisë nacionaliste) u përsëritën gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndaj hebrenjve, romëve etj., dhe gjatë zhbërjes së Jugosllavisë federale në vitet '90, ndaj boshnjakëve, shqiptarëve etj.

Studiuesi i spikatur i studimeve moderne të nacionalizmit, Anthony D. Smith, konsideron se nacionalizmi është ideologji në kuptimin e posedimit të parimeve të qarta (autonomi, unitet, identitet) dhe është i vulosur me një shenjë identike të përbashkët, të aktivitetit për kombësinë. Por njëkohësisht, sugjeron se gjithmonë duhet ti kemi parasysh variacionet ideologjike të nacionalizmit (konservativ, religjioz, sekular, imperial, separatist etj.).⁴⁰ Rrjedhimisht, nacionalizmi shqiptar (për dallim të nacionalizmave të vendeve fqinje), nuk ka eskaluar në të "keqen idealiste", por në vazhdimësi ka qenë nacionalizëm çlirimtar, sekular dhe egalitar: i karakterizuar nga lufta për liri, kultivimi i harmonisë ndër-fetare brenda identitetit kombëtar shqiptar, dhe kërkesës për barazi kombëtare/reciprocitet me kombet fqinje.

Pas Traktatit të Shën-Stefanit, agresionin serb ndaj shqiptarëve të mbështetur nga Rusia, nuk mundi ta ndalojë (si duhet) as Kongresi i Berlinit (1878), as Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1912-1913), dhe as Perandoria Osmane që njëkohësisht në vazhdimësi (që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit -1878), i kundërshtoi përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për shtet-formimin e shqiptarëve.

Kërkesat kombëtare të shqiptarëve u intensifikuan pas revolucionit gjonturk në vitin 1908, ngase gjonturqit nëpërmes "osmanizimit" që në fakt nënkuptonte nacionalizmin turk, ishin kërcënim për arritjen e deriatëhershme kulturore të shqiptarëve. Ndërsa vendet fqinje me politikat e tyre agresive i shprehnin hapur dëshirat për zgjerimin e territoreve të tyre. Në një situatë të tillë, shqiptarët për tu mbrojtur, u ngritën në kryengritjen kundër turqve, që filloi në Kosovë në mars të vitit 1910 dhe rezultoi me kryengritjet tjera, duke përfshirë kryengritjen e pranverës së vitit 1912⁴¹, që ishte vendimtare për nismën e dëbimit të osmanëve nga pothuajse të gjitha territoret evropiane. Për madhësinë e kësaj kryengritje të shqiptarëve, historiani Noel Malcolm, përveç tjerash shkruan: "*.....ç`është e drejta, vetëm kryengritja shqiptare e vitit 1912 i kishte bindur shtetet e Ballkanit se kishte ardhur koha për një luftë kundërosmane, ndërkohë osmanlinjtë ishin të dobësuar aq shumë, saqë lufta u fitua me shpejtësi. Sikundër që ka vënë në dukje gjashtë vjet më pas në memorandumimin e tij për shqiptarët, udhëtari dhe politikani anglez, Obri Herbert: Më në fund si Samsoni në Tempullin e Gazës, ata i shembën kolonat e Perandorisë Osmane mbi kokën e tyre. Janë shqiptarët ata të cilët i shpartalluan turqit, e jo serbët, as bullgarët dhe as grekët*".⁴² Në këtë vazhdë, me 8. tetor 1912, shpërtheu kryengritja e popujve ballkanik (Lufta e parë ballkanike) kundër perandorisë osmane, dhe vendet fqinje i shpërfillën dhe i sulmuan shqiptarët nga të gjitha anët, duke përfshirë pushtimin e Kosovës. Historiografia serbe, është përpjekur në vazhdimësi të paraqet këtë pushtim të Kosovës, si çlirim. Në lidhje me këtë, Malcolm përveç tjerash shkruan: "*Serbët do thonë çliruar, por madje edhe sipas llogaritjes së tyre, popullsia serbe-ortodokse ka qenë më pak se 25%. Popullsia shumicë ishte shqiptare dhe nuk e mirëpriti sundimin serb, kështu që "pushtuar" rezulton të jetë fjalë e drejtë*".⁴³

Përpjekjet e shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise prej vitit 1912, nuk u ndalën, dhe kulmuan me luftën e UÇK-s. UÇK e ndihmuar nga vendi amë “Shqipëria Londineze”, dhe NATO, e çliroi Kosovën nga regjimi neofashist i Millosheviqit. Në këtë vazhdë, OKB, e morri përgjegjësinë për të organizuar bashkësinë politike në Kosovë, në mes shqiptarëve, serbëve dhe të tjerëve. Në bazë të rezolutës 1244, të datës 10 qershor 1999, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-ës), u themelua Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-ës, në cilësinë e shefit të UNMK-ut, kishte autoritetin më të lartë në Kosovë, në bazë të kompetencave që përfshinin pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe administrimin e drejtësisë.

UNMIK-u, nuk kishte kompetenca që të mund të ushtronte presion të drejtpërdrejtë ndaj Serbisë, në kuptimin e ndikimit të drejtpërdrejtë në relacionin në mes shtetit serb dhe minoritetit serb në Kosovë (që shteti serb e përdor në vazhdimësi si instrument për të minuar organizimin e bashkësisë politike në Kosovë). Por kishte kompetenca të mjaftueshme që të ushtronte ndikimin e drejtpërdrejtë (duke përfshirë mundësitë për përdorimin e sanksioneve si mjete presioni) ndaj udhëheqjes politike shqiptare të Kosovës, që vazhdonte të mbetet e përçarë dhe në “luftë për pushtet”. E vetmja gjë që i bashkonte liderët politik shqiptar, ishte kërkesa për njohjen e pavarësisë së Kosovës, që bëhej (më shumë e më pak) për konsum të brendshëm politik, sepse tashmë (pas gjithë asaj që kishte ndodhur në Kosovë), kërkesa për pavarësinë e Kosovës, nuk ishte vetëm kërkesë politike, por njëkohësisht kërkesë jetike. Me fjalë të tjera, pas gjithë përvojave të hidhura me regjimet e Serbisë, prej vitit 1912 deri në vitin 1999, ishte e pamundur të bindeshin dhe të detyroheshin shqiptarët e Kosovës, që të mbesin sërish pjesë e Serbisë, dhe liderët politik shqiptar të Kosovës, ishin të vetëdijshëm se legjitimiteti i tyre varej nga kërkesa e pakthyeshme e popullit shqiptar të Kosovës, për pavarësim nga Serbia. Rrjedhimisht, procesi i ndikimit të UNMIK-t, prej vitit 1999 e veçanërisht prej vitit 2001 deri në vitin 2008, për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë, është i karakterizuar nga tri fazat e ndërlidhura me njëra-tjetrën, që rezultoi me organizimin e një “bashkësie politike multikulturaliste”, edhe pse mbi 90% të popullatës janë shqiptarë. Pikënisje konkrete për hyrjen në fazën e parë, në vitin 2001, ishte imponimi i rregullave konstitucionale nga ana e UNMIK-ut, përkatësisht detyrimi i liderëve politikë shqiptarë që të pranojnë kornizën kushtetuese etj. Faza e dytë filloi në vitin 2003, me kërkesën për përmbushjen e “Standardeve para statusit për Kosovën” dhe u ndikua nga trazirat e Marsit 2004 (që kanë pasur një efekt të dëmshëm dhe pothuajse të pariparueshëm për procesin e organizimit funksional të bashkësisë politike në Kosovë). Faza e tretë filloi në vitin 2005, me hapjen e negociatave për zgjidhjen e statusit final për Kosovën, dhe rezultoi me pakon e Ahtisarit dhe me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Në këtë vazhdë, Pavarësia e Kosovës u njoh nga shumica e shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-s), dhe me 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND), me qendër në Hagë, konstatoi se pavarësimi i Kosovës ishte i ligjshëm.

Shqiptarët përkundër sfidave, me sakrifica të mëdha dhe me përkrahjen e veçantë të Austrisë (Austro-Hungarisë), SHBA-së etj., arritën të pavarsojnë Republikën e Shqipërisë (1913) dhe Republikën e Kosovës (2008), si përpjekje drejt barazisë kombëtare me kombet fqinje. Megjithëkëtë, shteti serb me përcaktimin e tij të pandryshueshëm ekspansionist, vazhdon të minojë shtetësinë legjitime të Kosovës, duke u përpjekur ose të imponojë

themelimin e një “Republika Srpska” në Kosovë (të ngjashme sikurse në Bosnje), ose të aneksojë një pjesë të territorit strategjik të Kosovës, ose mundësisht që të dyjat, me qëllimin kryesor për të destabilizuar Kosovën dhe më gjerë, në të ardhmen. Ndërsa Hashim Thaçi, edhe pas vendimit të GjND-s, vazhdoi me negociata pa kushte, pa unitet të spektrit të gjerë politik shqiptar të Kosovës, dhe në këtë vazhdë Kosova është futur në një situatë të disfavorshme negociuese. Ky është treguesi më i mirë se pas vendimit të GjND-s, qasja politike e Thaçit, është konsumuar krejtësisht. Rrjedhimisht, është obligim historik dhe politik që partitë politike shqiptare në Kosovë në krye me Kadri Veselin etj., (i cili gjatë zgjedhjeve të kaluara e tregoj një shembull se është në gjendje të tejkalojë vetveten), të përbashkohen në një koalicion të gjerë (qeveritar dhe legjislativ) në krye me LVV si subjekt politik i pa provuar ende në pushtet, për të forcuar shtetësinë e Kosovës. Veçanërisht për të forcuar sistemin e drejtësisë, riorganizimin e mirëfilltë të burokracisë, zhvillimin ekonomik, dhe kthimin e besimit tek diaspora shqiptare për të kontribuar në mënyrë të organizuar (nëpërmes fondeve të caktuara etj.) për mirëqenie dhe zhvillim ekonomik në Kosovë. Nuk duhet harruar kurrë, se ideal dhe postulat i UÇK-s (i heronjve, i dëshmorëve dhe i viktimave të luftës), nuk ka qenë vetëm çlirimi i Republikës së Kosovës, por njëkohësisht ndërtimi i dinjitetshëm politik dhe juridik i Republikës Kosovës, drejtë bashkimit (unionit) kombëtar shqiptar. Gjithashtu, udhëheqësit politik shqiptar në “Shqipërinë Londineze”, e kanë obligim kombëtar të ndikojnë për unifikimin e faktorit politik shqiptar të Kosovës, në lidhje me negociatat me Serbinë. Ky obligim i përfshinë edhe intelektualët dhe akademikët shqiptarë në tërë hapësirën shqiptare (dhe kudo që jetojnë). Është e domosdoshme që elitat politike shqiptare të mësojnë njëherë e përgjithmonë nga gabimet e së kaluarës, në mënyrë që në të ardhmen, veprimtaria e tyre të jetë edhe më komplementare (një kombinim më i mirë i idealizmit dhe realizmit politik) drejt qëllimit të përbashkët. Veçanërisht duke i marrë parasysh mundësitë më të favorshme në kuadër të kontekstit të tashëm politik, kulturor dhe ekonomik të shqiptarëve, në Ballkan.

Përgjegjësia morale dhe politike e elitave në Ballkan është angazhimi për paqe të qëndrueshme dhe fqinjësi të mirë. Barazia kombëtare dhe respektimi i ndërsjellë-proporcional i të drejtave të minoriteteve kombëtare, përveçse është i drejtë, është edhe i domosdoshëm për paqe dhe stabilitet. Sepse ende jetojmë në epokën e nacionalizmit, dhe (pavarësisht se a e konsiderojmë nacionalizmin si “aksident historik” apo si proces historik drejt organizimit më të avancuar të shoqërisë njerëzore), kemi obligim moral dhe politik të interpretojmë nacionalizmin në mënyrën më konstruktive të mundshme: **si përpjekje për barazi me të tjerët dhe jo si urrejtje ndaj të tjerëve.**

Referencat:

¹ Adil Pireva (2014): “Osman Dumoshi – kryeorganizator i Demonstratave të ‘68-ës”: <http://illyriapress.com/osman-dumoshi-kryeorganizator-demonstratave-te-68-es/>

² Zymer Ujkan Neziri (2016): “Isa Demaj është figurë emblematike e brezit ‘68 të Republikës”: <https://www.radiokosovaelire.com/zymer-ujkan-neziri-isa-demaj-eshte-figure-embematike-e-brezit-68-te-republikes/>

³ Noel Malcolm, *KOSOVA një histori e shkurtër 2001*, f. 341-343

⁴ Po aty, f 339

⁵ Po aty, f 340

⁶ Svein Mønnesland, *Før JUGOSLAVIA og etter 2006*, f. 239

⁷ Rifat Muriqi (2013): “*Demonstrata e 81-it, një enigmë që duhet zgjidhur (I)*”: <https://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=1529>

⁸ Intervistë e Jusuf Gërvallës, botuar në gazetën gjermane TAGES ZEITUNG: https://m.gazetaexpress.com/arkiva/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tages-zeitung-131866/?arch_tb=temp

⁹ Emrush Xhemajli (2002): “*Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*”: <http://lpk-kosova.com/historiku.html>

¹⁰ Po aty

¹¹ Malcolm (2001): 363-364

¹² Rifat Blaku (2016): “*Referendumi i parë shqiptar në Kosovë u mbajt në mënyrë dinjitoze*”: <https://www.kosova-sot.info/opinione/140682/referendumi-i-pare-shqiptar-ne-kosove-u-mbajt-ne-menyre-dinjitoze/>

¹³ Mallcolm (2001): 368-369

¹⁴ Bardh Hamzaj, *Rrefimi për Luftën dhe Lirinë, 1999*, f. 179

¹⁵ Mønnesland (2006): 357

¹⁶ Dalja e UÇK-s në skenë, 28 nëntor 1997: <https://www.youtube.com/watch?v=MIMm5MaalB8&feature=youtu.be>

¹⁷ Gazeta Bujku: *Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-s*, 10 dhjetor 1997

¹⁸ Zëri (2014) *Preshevari që bëri stemën e UÇK-së*: <https://zeri.info/aktuale/8711/preshevari-qe-beri-stemen-e-uck-se/>

¹⁹ Shkëlzen Gashi, *ADEM DEMAÇI, biografi e paautorizuar 2010*, f.132

²⁰ Xhemajli (2002): <http://lpk-kosova.com/historiku.html>

²¹ Xhemajli (2002): <http://lpk-kosova.com/historiku.html>

²² Bedri Islami (2014): *Një dëshmi konkrete e angazhimit të personaliteteve të LPK-së në emigracion*, pasthënie në librin *Politika Nordike*....f. 261-267: <http://www.pashtriku.org/ngarkimet/dokumentet/Politika-nordike%20-%20LPK.pdf>

²³ Intervista e parë publike e përfaqësuesve të sektorit të rëndësisë së veçantë, Xhavit Halitit, Azem Sylës etj.: <https://youtu.be/q58OujSu-Ds> <https://www.facebook.com/ShqipChannel/videos/338922393384692/>

²⁴ Paraqitja e parë publike e zëdhënësit të UÇK-s, Jakup Krasniqit etj.: <https://youtu.be/qDbQg2sS9ac>

²⁵ Takimi me 24 qershor 1998, në Junik të Kosovës, i përfaqësuesve të UÇK-s, në krye me Hajdin Abazin, me të Dërguarin special të ShBa-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: <https://youtu.be/qzMXZKu2KWQ>

²⁶ Takimi me 29 qershor 1998, në Forumin Ndërkombëtar të Crans-Montanas, i përfaqësuesve të UÇK-s, në krye me Bardhyl Mahmutin, me të Dërguarin special të ShBa-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: <http://www.zemrashqiptare.net/news/19040/ina-interviste-me-bardhyl-mahmutin.html>

²⁷ Gazeta Le Temps: *Genève: un attentat vise le très discret Ministère kosovar de l'information*, 2 korrik 1998: <https://www.letemps.ch/suisse/geneve-un-attentat-vise-tres-discret-ministere-kosovar-linformation>

²⁸ Sabri Kijçari, *FITORJA DIPLOMATIKE, Kujtime nga përfaqësimi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës 2017*, f. 62, 64, 68

²⁹ “.....Përgjegjësia kryesore për atë që po ndodh në Kosovë bie mbi autoritetet jugosllave në Beograd. Milosheviq duhet të lehtësojë rrethanat në mënyrë që njësia e OSBE-s, të bëjë punën e vet, thotë Vollebæk ... ”:
<https://www.vg.no/nyheter/utenriks/i/RxR3M8/nato-frykt-for-ny-kosovo-krig>
<https://www.vg.no/nyheter/innenriks/i/m6R7v1/albanere-protesterte-mot-vollebaek-og-osse>

³⁰ *Radio-Kosova e Lirë, një histori autentike e informimit në luftë e në liri*, 26.01.2016:
<https://www.radiokosovaelire.com/radio-kosova-e-lire-nje-histori-autentike-e-informimit-ne-lufte-e-ne-liri/>

³¹ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi 2009*, f. 158

³² Gashi (2010): 150

³³ Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Selv-Government in Kosovo 1999, p.85 :
https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf

³⁴ Mønnesland (2006): 359

³⁵ Mønnesland (2006): 361

³⁶ Clausula rebus sic stantibus in internationals conventions (international agreements or treaties): Vienna Convention on the law of treaties (with annex). Concluded at Vienna on 23 May 1969, article 62:
https://www.law.cornell.edu/wex/rebus_sic_stantibus
<https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201155/volume-1155-i-18232-english.pdf>

³⁷ Mønnesland (2006): 362-363

³⁸ Edwin Jacques, *SHQIPTARËT; Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme 1995*, f.34-38,54,

³⁹ Malcolm (2001): 31-32

⁴⁰ Anthony D. Smith, *NATIONALISM 2008*, f. 9, 21, 42

⁴¹ Mønnesland (2006): 148-149

⁴² Malcolm (2001): 259

⁴³ Noel Malcolm (2008): “*Is Kosovo Serbia? We ask a historian*”
<https://amp.theguardian.com/world/2008/feb/26/kosovo.serbia>